



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

Nr. 315 Prot.

Tiranë, më 21.01.2020

Lënda: *Kërkohet dhënia e një opinioni mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcillet informacion i zgjeruar mbi veprimtarinë e Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED).*

Drejtuar: **Zoti Gianni BUQUICCHIO
PRESIDENT I KOMISIONIT TË VENECIAS
STRASBOURG, FRANCË**

Për dijeni: **EKSPERTËVE REPORTERË TË KOMISIONIT TË VENECIAS**

I nderuar Zoti Buquicchio,

Para së gjithash, përfitoj nga rasti që t'ju falenderoj për angazhimin tuaj personal, dhe në tërësi të Komisionit të Venecias, në ndihmë të forcimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri, për tashmë tre dekada.

Ndaj plotësisht të njëjtin mendim me konstatimin tuaj të urtë gjatë seancës plenare të 11 tetorit 2019, se ndihma e çmuar dhe e pakursyer e Komisionit të Venecias nuk mund të kurojë apo zëvendësojë mungesën e kulturës dhe vullnetit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shqiptare.

Që nga Opinioni i fundit që Komisioni i Venecias hartoi në përgjigje të Kuvendit të Shqipërisë, fatkeqësisht ende nuk ka asnjë reflektim ndaj këshillave dhe rekomandimeve tuaja.

E në mungesë, prej më shumë se dy vjetësh të Gjykatës Kushtetuese, në mungesë të Gjykatës së Lartë, në kushtet e një krize *sui generis* të përfaqësimit ku Qeveria, Kuvendi, të gjitha Bashkitë dhe Këshillat Bashkiakë janë në duart e një force të vetme politike, ashtu si dhe pjesa dërrmuese e

organeve të pavarura emëruar nga kjo forcë politike, duke sjellë çekuilibrim të plotë të mekanizmave të kontrollit dhe balancës, vendi ndodhet përpara rrezikut të kapjes totale të shtetit.

Ky kontekst shoqëruar me zbatimin e njëanshëm, antikushtetues dhe në shkelje flagrante të rekomandimeve të Komisionit të Venecias mbi reformën në drejtësi, po zhyt gjithmonë e më shumë vendin në paligjshmëri, antikushtetutshmëri, dhe drejt autokracisë.

Nëse rekomandimet e Komisionit të Venecias, kyç në arritjen e konsensusit unanim për miratimin e ndryshimeve kushtetuese në vitin 2016, do të ishin zbatuar me përpikmëri, atëherë vendi nuk do të gjendej sot përpara kësaj krize *sui generis*.

Është për të ardhur keq që institucioni kryesor i keqzbatimit të reformës në drejtësi është pikërisht Kuvendi, tashmë mono-partiak.

Kjo qasje e njëanshme imponuese dhe jobashkëpunuese e Kuvendit u ndoq edhe me nisjen e procesit të ringritjes së Gjykatës Kushtetuese, duke tentuar rrëmbimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës dhe si pasojë kapjen edhe të institucionit më të lartë të drejtësisë.

Kuvendi i Shqipërisë, i kërkoi Komisionit të Venecias në korrik 2019, një opinion mbi kompetencat e Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve, në kuadër të Komisionit Hetimor Parlamentar për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Në datën 14 tetor 2019, Komisioni i Venecias i paraqiti Kuvendit Opinionin nr. 959/2019, ku në thelb, u evidentua se veprimtaria e Presidentit nuk hyn në sferën e shkeljeve që mund të **autorizojnë një shkarkim të Presidentit. Përkundër këtij rekomandimi, Kuvendi i Shqipërisë** shtyu dy herë afatin e veprimtarisë së Komisionit Hetimor, me qëllim vijimin e presionit sistematik ndaj Presidentit për të emëruar në Gjykatën Kushtetuese kandidatë që gëzonin mbështetjen politike të mazhorancës.

Kuvendi madje zgjeroi objektin e komisionit hetimor parlamentar dhe anatemoi vendimet e Presidentit të Republikës në emërimin e gjyqtarëve kushtetues, duke i veshur vetes epërsi statutore në procesin e ngritjes së Gjykatës Kushtetuese.

Vetëm dy muaj pas Opinionit të Komisionit të Venecias, Kuvendi i drejtohet sërish Komisionit më 30 dhjetor 2019 për një tjetër opinion. Qëllimi i pafshehur i Kuvendit është të tentojë sërish mbulimin e vendimit për shkarkimin e Presidentit nën siglën e Komisionit të Venecias, dhe kapjen politike edhe të Gjykatës Kushtetuese.

Mungesa e bashkëpunimit nga Kuvendi i Shqipërisë me Presidentin e Republikës në këtë proces, është e evidente dhe e mirëdokumentuar.

Institucioni i Presidentit të Republikës është njohur lidhur me kërkesën që Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë i ka përcjellë Komisionit të Venecias vetëm përmes medias¹.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kësaj kërkesë, konstatohet parashtrimi i njëanshëm i fakteve dhe rrethanave nga Kuvendi. Të dhënat thelbësisht të shtrembëruara dhe pyetjet vetësugjeruese të Kuvendit orientojnë një lexim të gënjeshtërt të situatës.

E gjithë kjo bëhet në keqbesim me qëllimin për të shtyrë Komisionin e Venecias në nxjerrjen e konkluzioneve jo të drejta që më pas të keqpërdoren politikisht nga mazhoranca.

Presidenti i Republikës vlerëson se mirëbesimi i Komisionit të Venecias, investuar prej gati 30 vitesh në dobi të shtetit të së drejtës në Shqipëri, nuk mund dhe nuk duhet të shpërdorohet për qëllime politike të ditës, por për të përfituar nga përvoja më e mirë e praktikës gjyqësore europiane.

Nisur nga kriza e rëndë e paprecedentë ku ndodhet sot vendi im, dhe kur mijëra shqiptarë po braktisin vendin për shkak të mosfunksionimit të shtetit të së drejtës dhe cenimit të lirive themelore, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj dhe të Komisionit të Venecias se ky Opinion do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në rrugën që do të marrë Shqipëria, drejt demokracisë apo drejt instalimit të diktaturës.

I nderuar Zoti Buquicchio,

Në këto kushte, për të realizuar një proces të plotë këshillimor bazuar në të dhëna zyrtare që dëshmojnë përmasën e thellë të veprimeve antikushtetuese të Kuvendit të Shqipërisë, Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe drejtuesve të institucioneve të tjera që kanë bashkëpunuar me të, e që faktojnë ecurinë reale të procesit të emërimit të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës, ka vlerësuar t'i përcjellë Komisionit të Venecias, një informacion të plotë mbi këtë çështje, pasuar me një listë pyetjesh që kërkojnë dhënien e një opinioni, që të qartësojë kushtetutshmërinë e veprimeve të secilit prej organeve.

Duke ju siguruar për konsideratën më të lartë,

Sinqerisht,

Ilir Meta

¹ Kërkesa e Kuvendit drejtuar Komisionit të Venecias ende nuk është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

**A. INFORMACION I ZGJERUAR MBI VEPRIMTARINË E PRESIDENTIT TË
REPUBLIKËS, KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË
EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED) MBI PROCESIN E ZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

DHE

**PYETJET E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E NJË
OPINIONI MBI EMËRIMIN/ZGJEDHJEN E GJYQTARËVE TË GJYKATËS
KUSHTETUESE²**

I. Baza ligjore e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese

Emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, procedura, plotësimi i vakancave, ripërtëritja e përbërjes, radha e emërimit, organet e emërtesës që kanë të drejtë të emërojnë apo zgjedhin dhe institucioni kompetent për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, është e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ndryshimet kushtetuese, të realizuara në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në datat 21-22 korrik 2016, i kushtuan rëndësi të posaçme mënyrës sesi do të zgjidheshin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, si dhe mënyrës sesi do të ripërtërihej përbërja e kësaj gjykate.

Kushtetuta e Republikës, në nenin 125, pikat 1 dhe 2, parashikon se Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.

² Në kuadër edhe të kërkesës së Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë 4531 prot, datë 30.12.2019 drejtuar Komisionit të Venecias për dhënie opinionioni.

Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë, shpallet i emëruar.

Ky rregullim ka qenë me shumë rëndësi për kushtetutëbërësin, aq sa, në të njëjtën dispozitë të nenit 179, në pikat, 2, 3 dhe 12, është saktësuar koha dhe rradha e emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të gjykatës:

*“[...] 2. Anëtar i parë për t’u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. **Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.***

3. Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit. [...]

*12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 136 të Kushtetutës. **Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2, të këtij neni, dhe nenit 125 të Kushtetutës”.***

Këto rregullime kushtetuese, sa i takon emërimit/zgjedhjes së anëtarëve dhe radhës për secilin organ emërtese, kanë gjetur zbërthim në **nenet 7, 7/a, 7/b dhe 86, pikat 4 të ligjit nr. 8577/2000,** “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku pasqyrohet me hollësi sesi këto detyrime duhen përmbushur.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese në dispozitat e sipërcituara, ndër të tjera përcakton se ky rregull ndiqet edhe në rastet e përfundimit para afatit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, dhe radhën e emërimit/zgjedhjes për secilin nga organet e emërtesës duke saktësuar radhën edhe për plotësimin e çdo mandati të gjyqtarëve që u ka përfunduar apo pritej t’i përfundonte mandati kushtetues (neni 86, pika 4, e ligjit nr. 8577/2000).

Neni 86 pika 4, e ligjit nr.8577/2000, parashikon përtëritjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese sipas ligjit të ri, pas ndryshimeve kushtetuese. Konkretisht kjo dispozitë parashikon:

*“4. Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese **deri në vitin 2022 do të bëhet sipas skemës së parashikuar më poshtë:***

*a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati **në vitin 2016,** emërohen **sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.***

b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025.

*c) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati **në vitin 2019,** emërohen **sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.***

ç) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2028.

d) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë.”

Ndërkohë që, Kushtetuta në nenin 149/d, parashikon se, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organi që kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. **Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative.

Këshilli e ushtron detyrën me mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 janar të çdo viti kalendarik. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë.

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet në nenet 217- 242, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar si dhe për aq sa është e mundur përmes dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) e ushtron veprimtarinë e tij **në mënyrë kolegjiale** dhe për nga mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së tij, ai funksionon si një organ **kolegjial administrativ**.

KED sipas nenit 229- 230 të ligjit nr. 115/2016, ka përgjegjësinë të miratojë me vendim rregulla për organizimin dhe funksionimin dhe rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.

Kompetencat e Kryetarit të KED janë të përcaktuara në nenin 226 të Ligjit nr. 115/2016 si vijon:

“Neni 226

Kryetari

1. Anëtari i Gjykatës së Lartë është kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
2. Kryetari i Këshillit ushtron këto funksione:

- a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit;
- b) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët;
- c) siguron mbështetjen administrative, organizative dhe financiare të Gjykatës së Lartë për funksionimin e Këshillit;
- ç) harton dhe bën publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë raportin vjetor mbiveprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
- d) siguron që mbledhja e Këshillit të regjistrohet në sistemin audio dhe që një përmbledhje e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit mbahet dhe bëhet publik në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Përmbledhja e procesverbalit u vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit përpara se të bëhet publike. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes së procesverbalit, Kryetari i Këshillit urdhëron ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio dhe ndryshimin e saj në qoftë se dyshimi i anëtarit rezulton i justifikuar;
- dh) siguron dokumentimin e mbledhjes së këshillit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;
- e) nënshkruan aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe ia përcjell ato organit të emërtesës;
- ë) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.”

Sipas nenit 149/d të Kushtetutës dhe nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe harton një raport për veprimtarinë e KED-së dhe zgjedhjen e tij.

Ndërkohë që sipas nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

II. Bllokimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për dy vite 2017-2018 dhe nxjerrja jashtë funksionit e Gjykatës Kushtetuese.

Një nga momentet më evidente të keqzbatimit të Reformës në Drejtësi ishte dalja jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese prej më shumë se 2 (dy) vitesh.

Për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, është i domosdoshëm funksionimi i KED, i cili është organi që bën vlerësimin, renditjen dhe listimin e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, që i përcillen për emërim/zgjedhje organeve të emërtesës (President, Kuvend, Gjykatë e Lartë).

Pas miratimit të ndryshimeve Kushtetuese (korrik 2016), Kuvendi ka zgjedhur me short vit pas viti 3 (tre) Këshilla të Emërimeve në Drejtësi, për të funksionuar përgjatë viteve 2017, 2018, 2019, ndërkohë që KED 2020 është zgjedhur me shortin e zhvilluar nga Presidenti i Republikës në datë 5.12.2019.

Dy Këshillat e zgjedhur për të punuar përgjatë **viteve 2017 dhe 2018**, nuk kanë funksionuar, pasi janë bllokuar qëllimisht nga Kryeministri dhe përfaqësues të mazhorancës së Partisë Socialiste.

Presidenti i Republikës, ka konstatuar në vijimësi përpjekjet e Kryeministrit për të nxjerrë nga kontrolli kushtetues qeverinë dhe Kuvendin, si dhe për të kapur politikisht institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë, pas realizimit të reformës kushtetuese të sistemit të drejtësisë.

Kuvendi, në datë 27 janar 2017, organizoi shortin në mënyrën më transparente dhe përzgjedhi për herë të parë KED. Ky ishte momenti i parë kyç për ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas ndryshimeve kushtetuese.

Asnjë gjyqtar apo prokuror nuk kundërshtoi listat e kandidatëve pjesëmarrës në short për zgjedhjen e KED, si dhe rezultatet e shortit të hedhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kryeministri Rama 4 (katër) ditë pas hedhjes së shortit, doli hapur dhe publikisht për të shprehur mospëlqimin e tij për anëtarët e KED. **Në datë 31 janar 2017**, Kryeministri Rama, publikisht dhe drejtpërdrejt, kërcënoi të gjithë anëtarët e KED, duke shantazhuar se do t'i shkarkonte me *vetting*. Kryeministri shfaq hapur se kishte në dorë, jo vetëm të bllokonte Këshillin, por edhe t'i shkarkonte më shumë se gjysmën e tyre³. Pas këtij presioni publik të Kryeministrit, **anëtarët e KED dhanë dorëheqjen. Gjithashtu, disa anëtarë të KED u shkarkuan nga funksioni bazë nga procesi *vetting*.**

Pra Kryeministri Rama sulmoi institucionin e parë të Reformës në Drejtësi, pikërisht për faktin se anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk i përgjigjeshin interesave të Kryeministrit. **Ky Këshill nuk u mbledh asnjëherë dhe mandati i tij përfundoi më datë 31.12.2017, pa kryer asnjë mbledhje të vetme.**

Nëse KED 2017 do të funksiononte, Gjykata Kushtetuese do të ishte plotësuar dhe do të ishte gjithmonë funksionale për të kontrolluar veprimtarinë dhe vendimet e Kryeministrit, Qeverisë, Kuvendit dhe gjithë institucioneve të tjera.

Në datë 7 dhjetor 2017 Kuvendi hodhi përsëri shortin dhe zgjodhi KED që do funksiononte përgjatë vitit 2018. Sërish u shfaqën të njëjtat problematika me listat. Edhe emrat që rezultuan

³ Shiko Deklaratën e Kryeministrit Rama: Burimi: Top Channel, datë 31 Janar 2017, në link=un: <http://top-channel.tv/video/rama-kunder-ked-gjysma-ikin-nga-vettingu/>

nga kjo procedurë shorti sërish nuk gëzonin pëlqimin e Kryeministrit Rama dhe mazhorancës socialiste të udhëhequr prej tij.

Presidenti i Republikës, në shkurt 2018 i kërkoi zyrtarisht KED që të mblidhej dhe të shqyrtonte me precedencë të gjitha kandidaturat e paraqitura për plotësimin e të gjitha vakancave të shfaqura në Gjykatën Kushtetuese.

Ndërkohë që Presidenti i Republikës në **shkurt 2018**, i kërkoi KED që të mblidhej dhe ushtronte funksionet kushtetuese, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Ligjeve, z. Ulsi Manja, në datë **5 Mars 2018** në një deklaratë publike⁴ u bëri thirrje anëtarëve të KED të kalonin *vetting*-un përpara se të fillonin ushtrimin e detyrës për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.

Në datë 19 mars 2018, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Ligjeve, z. Ulsi Manja, u shfaq në mbledhjen e parë dhe të vetme të KED, duke shantazhuar drejtpërdrejt anëtarët e këtij organi. Në këtë mbledhje z. Manja debatoi me anëtarët e KED dhe u përsëriti atyre të njëjtin qëndrim se KED mund të mblidhet për veprimtari administrative, **por jo për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese**⁵.

Kryetari i Komisionit të Ligjeve z. Ulsi Manja u kërkonte anëtarëve të KED, që të mos ushtronin funksionin e tyre, me alibinë e një dispozite tranzitore, afati i së cilës kishte përfunduar.

Qëndrimi i zotit Manja në lidhje me *vetting*-un e anëtarëve të KED, hidhet poshtë edhe nga anëtarja e Komisionit të Venecias, njëkohësisht eksperte e nivelit të lartë gjatë hartimit të reformës kushtetuese në drejtësi, Prof. Dr. Aurela Anastasi⁶.

Pasoja e këtij shantazhi të drejtpërdrejtë ishte fakti që pas datës 19 mars 2018 KED nuk u mblodh më asnjëherë.

Kështu u bllokua edhe me 1 (një) vit tjetër funksionimi i KED.

Kryetari i Komisionit Parlamentar të Ligjeve **z. Ulsi Manja, është aktualisht edhe Kryetar i Komisionit Hetimor Parlamentar** të ngritur ndaj Presidentit të Republikës, që po heton, ndër të

⁴ Shiko deklaratën e z. Ulsi Manja, Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, në datën 5 mars 2018, në linqet:

-<http://www.gsh.al/2018/03/05/ulsi-manja-per-anetaret-e-ked-ti-nenshtrohen-vetting-ut-para-se/>

-<http://tv1-channel.tv/2018/03/05/ulsi-manjaanetaret-e-ked-duhet-ti-nenshtrohen-vettingut/>

-<https://sot.com.al/politike/ulsi-manja-p%C3%ABr-an%C3%ABtar%C3%ABt-e-ked-nuk-ka-mbledhje-pa-kaluar-vetting-un>

⁵ Shiko përmbledhjen e procesverbalut të Mbledhjes së KED, datë 19.03.2018, faqe 10, në link-un:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Procesverbali_i_mbledhjeve_184_1.php

⁶ Shiko deklaratën/video bashkëlidhur <https://www.tpz.al/2019/11/09/video-ulsi-manja-nuk-pyet-per-mendimin-e-eksperteve-si-po-mbahet-peng-ked-del-dhe-kunder-fatmir-xhafajt/>

tjera, edhe mbi kompetencat kushtetuese të Presidentit për emërimin e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese!

Nëpërmjet këtyre lëvizjeve, Kryeministri Rama dhe mazhoranca në Kuvend shantazhuan Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për **2 vite me radhë, 2017 dhe 2018**, dhe bllokuan emërimin e gjyqtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa **procesi vetting po boshatiste plotësisht Gjykatën Kushtetuese. Mazhoranca Socialiste bllokoi funksionimin e KED për të mos lejuar plotësimin e vendeve vakante.**

Nëse KED do të kishte funksionuar normalisht gjatë viteve 2017 dhe 2018, vakancat e shfaqura në Gjykatën Kushtetuese do të ishin plotësuar një e nga një, sipas momentit kur këto vakanca u shfaqën.

Nëse Gjykata Kushtetuese do të funksiononte, ajo do të mund të shqyrtonte kontestimin e 23 ligjeve të miratuara nga Kuvendi, të gjetura në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe që cenojnë rëndë interesin publik.

Në datë 7 dhjetor 2018 Kuvendi hodhi përsëri shortin dhe zgjodhi Këshillin e përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi, që do funksiononte përgjatë vitit 2019. Edhe në këtë proces u shfaqën të njëjtat problematika me listat e kandidatëve pjesëmarrës në short.

Në këtë periudhë, numri i anëtarëve të Gjykatës së Lartë, kishte rënë në mënyrë drastike dhe në short, merrnin pjesë vetëm 3 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, ku midis tyre përzgjidhet si anëtar i KED, zoti Ardian Dvorani dhe zoti Medi Bici si anëtar zëvendësues.

Sipas ligjit, anëtari i KED i zgjedhur nga Gjykata e Lartë është dhe Kryetar i KED. Mazhoranca këtë herë, nuk kundërshtoi emrat e anëtarëve të KED, pasi në krye të këtij organi arriti të zgjidhte zotin Ardian Dvorani, i cili njihet si një gjyqtar që gëzon mbështetjen e hapur të mazhorancës socialiste.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi funksionoi përgjatë vitit 2019 me numër të kufizuar anëtarësh. KED filloi nga funksionimi vetëm me 7 anëtarë, nga 9 që kërkon Kushtetuta, dhe e përfundoi punën e tij me 5 anëtarë. 3 gjyqtarë (anëtarë të KED) iu nënshtruan *vettingut* gjatë kohës që kryenin detyrën në KED dhe një prej tyre u shkarkua. Edhe nga 3 anëtarët zëvendësues të KED, dy prej tyre iu nënshtruan procesit *vetting* përgjatë ushtrimit të detyrës dhe një prej tyre u shkarkua.

Kuvendi i Shqipërisë nuk ndërmori asnjë nismë për plotësimin e legjislacionit me qëllim krijimin e bazës ligjore për hedhjen e shortit, për plotësimin e vendeve vakante në KED, edhe pse Presidenti i Republikës e ka konstatuar këtë boshllëk ligjor dhe i ka kërkuar Kuvendit ndërmarrjen e nismës ligjore mbi këtë çështje që prej korrikut 2018.

Mazhoranca socialiste nuk kundërshtoi as faktin që KED e tretë (2019) filloi të funksiononte, ndërkohë që 3 prej 7 anëtarëve të saj, ishin gjyqtarë të cilët ende nuk kishin përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar (qëndrim ky çuditërisht i kundërt me atë të mbajtur nga mazhoranca për dy vitet 2017-2018 dhe KED-të pararendëse).

Kryetari i KED, Ardian Dvorani njihet për lidhje të afërta me mazhorancën qeverisëse. Ai është zgjedhur si gjyqtar i Gjykatës së Lartë në shkurt të vitit 2004, kur Kuvendi dominohej nga Partia Socialiste.

Ai vazhdon të ushtrojë detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë prej 16 vjetësh, ndonëse Kushtetuta parashikon se mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është 9-vjeçar.

Në vitin 2012, Dvorani, ndonëse ushtronte detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, mori pjesë në tryezat e organizuara nga Partia Socialiste, në atë kohë në opozitë, duke dhënë kontribut për hartimin e programit politik të kësaj force për sistemin e drejtësisë. Ky fakt **u raportua nga mediat e kohës**⁷, por në atë kohë në Shqipëri mungonin rregullat për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Në vitin 2016, Kuvendi ishte duke shqyrtuar ndryshimet kushtetuese në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë. Ndërkohë po në këtë periudhë, Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit 3, të nenit 5, të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, që lejonte gjyqtarin e Gjykatës së Lartë të qëndronte në detyrë përtej mandatit, deri në zëvendësimin e tij⁸. Shfuqizimi i këtij neni të ligjit nga Gjykata Kushtetuese passillte ndërprerjen e menjëhershme të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani.

Qeveria bllokoi publikimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Fletoren Zyrtare, derisa hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese të Reformës në Drejtësi⁹. Këto ndryshime kushtetuese përmbajnë një rregull sipas të cilit, edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë përtej afatit 9 vjeçar, derisa zëvendësohen.

⁷ Shiko raportimet në linqet:

-<http://top-channel.tv/2011/10/30/tryeza-e-drejtësisë-pd-propagande/>

-<http://www.panorama.com.al/tryeza-e-ps-pd-vizioni-i-ramës-i-mbrapshte/>

-<https://www.youtube.com/watch?v=pjQdXk3ZJlw&app=desktop>, **minuta 31:25 – 38:05**.

-<https://www.youtube.com/watch?v=gAd7z4var58>, **minuta 17:40 – 20:35**.

⁸Shiko Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 55/2016, shpallur në datë 27.07.2016, dhe Botuar në Fletoren Zyrtare nr. **152, datë 12.08.2016** (hyrë në fuqi po në këtë datë). Shtyrja e botimit në Fletoren Zyrtare, bëri që hyrja në fuqi e këtij vendimi të përkonte me një ditë pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese (11.08.2016).

⁹ Ligji nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, u shpall me dekretin nr. 9706, datë 26.07.2016, u botua në Fletoren Zyrtare **nr. 138, datë 27.07.2016** dhe hyri në fuqi në datë **11.08.2016**.

Ky rregull i ri kushtetues ka vlerë vetëm për emërimet e reja në Gjykatën e Lartë, pra për anëtarët që do të emërohen sipas regjimit të ri kushtetues. Por përkundër këtij rregullimi të qartë kushtetues dhe përkundër urdhërimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, anëtari i Gjykatës së Lartë Ardian Dvorani pretendoi se rregulli i ri kushtetues shtrihej edhe mbi mandatin e tij.

Në këto rrethana, duke përdorur botimin me vonesë në Fletoren Zyrtare të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Ardian Dvorani u rikthye sërish në zyrë dhe filloi të ushtronte sërish detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, duke u zgjedhur nga Kuvendi në dhjetor 2018 edhe si anëtar/Kryetar i KED që do të funksiononte përgjatë vitit 2019.

Të gjitha faktet mbi lidhjet politike dhe ndikimin politik në bërjen të mundur të zgjatjes së mandatit si gjyqtar i Gjykatës së Lartë të zotit Ardian Dvorani, përtej çdo niveli të logjikës dhe të kërkesave të Kushtetutës, të marra veçmas ose së bashku, **cenojnë legjitimitetin dhe besueshmërinë e veprimtarisë së KED.**

Qasja e mbështetjes dhe ndikimit politik në favor të mazhorancës qeverisëse u dëshmuar në veprimtarinë e Kryetarit të KED në kohën dhe mënyrën e përcjelljes së listave të kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, përkundërt Presidentit dhe Kuvendit.

Mënyra dhe koha e ndryshme e dërgimit të listave synonin vënien në pamundësi të Presidentit të Republikës për të ushtruar kompetencat e tij, që do të sillte favorizimin e kandidatëve të preferuar të mazhorancës socialiste.

III. Problematika e krijuar nga aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) 2019

- **Kufizimi i pjesëmarrjes së institucionit të Avokatit të Popullit në veprimtarinë e KED.**

KED miratoi 3 aktet nënligjore që rregullonin: organizimin dhe funksionimin; verifikimin e kandidatëve; vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve të mbetur në garë.

Me miratimin e këtyre akteve, KED në disa momente, ka kapërcyer kufijtë që i përcakton Kushtetuta dhe ligji në rregullimin e disa çështjeve thelbësore të mënyrës së ushtrimit të kompetencave të tij.

Kushtetuta në nenet 149/d, 179/11 dhe neni 233 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcaktojnë qartë rolin e Avokatit të Popullit, si subjekt që merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e KED, si një vëzhgues permanent me rol garantues aktiv të respektimit të të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, në gjithë veprimtarinë e KED.

Me aktet nënligjore të miratuara, KED vendosi që bisedimet e çështjeve në KED, si dhe votimi i vendimit bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit, duke e kufizuar këtë të drejtë kushtetuese. KED i mohoi Avokatit të Popullit një të drejtë të sanksionuar në Kushtetutë dhe ligj, duke e përjashtuar Avokatin e Popullit nga procesi i diskutimit të çështjeve, si dhe votimit të vendimeve.

Edhe përse këto çështje janë ngritur në mbledhjet e KED në momentin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, dhe në vijimësi, si nga Avokati i Popullit, apo përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, sërish asnjë kërkesë e kësaj natyre nuk u mor parasysh.

Ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, në nenet 7/b, pika 3; 7/c, pikat 4 e 7, përcakton se, nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli **harton dy lista të veçanta**. Një prej listave është me kandidatët nga radhët e gjyqësorit, me qëllim që KED dhe më pas organet e emërtesës, të kenë mundësi objektive për të vepruar në respektim të plotë të normës, në mënyrë që të sigurohet balanca e përbërjes në Gjykatës Kushtetuese midis kandidatëve magjistratë dhe jo magjistratë.

Në kundërshtim me këtë kërkesë të ligjit, KED duke i dhënë vetes attribute të legjislatorit, miratoi aktin nënligjor - Vendimin nr. 5, datë 02.04.2019, ku në një dispozitë tranzitore (shkronja “ë” e vendimit), vendos se do të procedojë me paraqitjen pranë organeve të emërtesës të një liste të vetme përfundimtare të renditjes së kandidatëve, për çdo vend vakant.

Ky përcaktim i bërë në një akt nënligjor të KED, solli si rezultat që zbatimi i këtyre dy dispozitave të ligjit për të siguruar balancën e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese nuk u përmbush. KED, në kundërshtim me ligjin, u përcollti organeve të emërtesës (President, Kuvend), nga një listë për secilën vakancë.

Për këto çështje dhe të tjera, Avokati i Popullit, në muajin dhjetor 2019, ka paraqitur pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, një kërkesë padi, ku ka kundërshtuar të gjitha aktet nënligjore të KED, të sipërcituara.

- **Qëndrimi i KED, mbi procesin e rivlerësimit kalimtar (*vetting-ut*) të kandidatëve që i nënshtrohen aplikimit të ligjit nr. 84/2016.**

Ligji nr. 8577/2000, në nenin 7/a, pika 1/dh, ka përcaktuar që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush kushtin **që të ketë kaluar me sukses** procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

Për kandidatët magjistratë, ky proces do të kryhej nga organet e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, ndërsa për kandidatët jo magjistratë ky proces realizohet nga KED, nëpërmjet hetimit administrativ të tij. Përcaktimi i këtij kushti, pra “kalimi me sukses”, i procesit të kontrollit të

pasurisë dikton që kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duhet të kenë një vendim pozitiv dhe përfundimtar si të organeve të rivlerësimit, ashtu dhe të KED, sipas ligjit.

KED, në aktin e tij nënligjor Vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, vendosi që të gjithë kandidatët për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë, për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kalimit me sukses të verifikimit të pasurisë dhe kontrollit të integritetit të kandidatëve, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (shkalla e parë), pa pritur vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Sipas këtij akti të KED, një kandidat magjistrat që ka kaluar me sukses shkallën e parë të *vetting*-ut në KPK, lejohet të kandidojë dhe të vijojë konkurimin dhe nuk i nënshtrohet procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të integritetit, të parashikuar nga nenet 235 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016.

Standarti që ka vendosur KED, për të marrë në konsideratë vetëm vendimin e shkallës së parë të organeve *vetting*, pra të KPK-së, duke mos pritur vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mund të sillte si rezultat që një kandidat fitues për një vakancë në Gjykatë Kushtetuese, pasi të jetë renditur dhe mund të jetë emëruar/zgjedhur nga Presidenti/Kuvendi/Gjykata e Lartë, të bartë me vete rrezikun që të shkarkohej nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

Në këtë mënyrë, do të riciklohej sërish një vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, duke çuar në cenimin rëndë të besimit të publikut tek institucionet e reja të sistemit të drejtësisë.

Pikërisht për këtë shkak, nga përfaqësuesi i Presidentit të Republikës dhe Avokatit të Popullit, gjatë momentit të hartimit të akteve nënligjore (shkurt- mars 2019) dhe në vijimësi, u kërkua që KED, të mos e miratonte këtë akt nënligjor në këtë standart, por KED nuk reflektoi mbi këtë kërkesë. Kjo bëri që KED, në listat e përcjella përpara Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, të përfshinte në listë kandidatë magjistratë, të cilët nuk kishin përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë (kandidatët Besnik Muçi dhe Regleta Panajoti).

Pasi Presidenti i Republikës, në datën 15 tetor 2019, zgjodhi z. Besnik Muçi, si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ndodhi pikërisht që Kolegji i Posaçëm i Apelimit, të riaktivizohej dhe me vendim të datës 21 nëntor 2019, ky Kolegj vendosi të pranojë ankimin e Komisionerit Publik dhe të shkarkojë z. Muçi nga detyra, duke krijuar sërish një vakancë të parakohshme në këtë gjykatë për t'u plotësuar dhe duke shtyrë kështu procesin e formimit të një Gjykate Kushtetuese funksionale për disa muaj.

- **Moszbardhja dhe mospublikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të KED**

Sipas parashikimeve të nenit 226, 232, të ligjit nr.115/2016, por edhe në respektim të pikës 17 të Vendimit të KED nr.1, datë 08.02.2019, Kryetari i KED, ka përgjegjësinë e marrjes së masave për mbajtjen, administrimin, zbardhjen, konsultimin, miratimin dhe publikimin në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë të përmbledhjes së procesverbaleve të çdo mbledhje të Këshillit. Shqyrtimi i procesverbaleve duhet të realizohet në mbledhjen pasardhëse të Këshillit dhe publikimi i përmbledhjes së tyre, përveçse është detyrim ligjor, siguron dhe zbatimin e parimit të transparencës.

KED, përgjatë gjithë veprimtarisë së tij në vitin 2019, ka zhvilluar gjithsej 39 (tridhjetë e nëntë) mbledhje. Përgjatë gjithë vitit 2019, KED, nuk shqyrtoi dhe nuk miratoi në mbledhjet pasardhëse asnjë procesverbal apo përmbledhje të tij për mbledhjet pararendëse. Të gjitha përmbledhjet e procesverbaleve, së bashku për gjithë mbledhjet e zhvilluara, u zbardhën dhe miratuan vetëm në muajin dhjetor 2019, në përfundim të mandatit të KED.

Në faqen e Gjykatës së Lartë, për një vit rresht, deri në datën 30 dhjetor 2019, gjendej i publikuar vetëm procesverbali i mbledhjes së parë të KED, zhvilluar në datën 15 janar 2019, edhe pse në mënyrë të vazhduar nga përfaqësuesi i Presidentit të Republikës dhe Avokati i Popullit, është kërkuar përgjatë mbledhjeve të KED, zbardhja e procesverbaleve.

Për këtë shkelje flagrante të ligjit nga Kryetari i KED, Presidenti i Republikës, në datën 19.11.2019, ka paraqitur kallzim penal pranë organit të Prokurorisë së Posaçme SPAK, duke e akuzuar atë për veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”¹⁰, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo çështje është nën hetim penal, edhe për fakte të tjera penale që lidhen me veprimtarinë e tij në dërgimin e listave përkundrejt organeve të emërtesës.

Institucioni i Presidentit të Republikës ka publikuar dy spote (shqip&anglisht), në datat 10 dhe 18 dhjetor 2019, që pasqyrojnë qartë shkeljet kushtetuese dhe ligjore të Kryetarit të KED-së, në: <http://president.al/spoti-pare-ne-mbrojtje-te-kushtetutes-dhe-integritetit-te-gjykates-kushtetuese/>; <http://president.al/spoti-dyte-ne-mbrojtje-te-kushtetutes-dhe-integritetit-te-gjykates-kushtetuese/>

Institucioni i Avokatit të Popullit me rol të posaçëm vëzhguesi të përhershëm ka hartuar një Raport me gjetjet paraprake të konstatuara në veprimtarinë e KED përgjatë vitit 2019, ku duke përfshirë çështjet e mësipërme, ka evidentuar edhe një sërë problematikash të tjera të keqfunksionimit të Kryetarit dhe KED. Ky raport është tashmë publik¹¹.

IV. Shpallja për aplikim e vakancave në Gjykatën Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese përgjatë dy viteve 2017- 2018 të mosfunksionimit të KED, u përball me boshatisjen e saj. Kjo për shkak se disa gjyqtarëve u përfundoi mandati kushtetues, ndërkohë që

¹⁰ Shiko Kallëzimin Penal të Presidentit të Republikës bashkëlidhur, ose në link-un: <https://president.al/presidenti-meta-kallezon-penalisht-kryetarin-e-keshillit-te-emerimeve-ne-drejttesi-z-ardian-dvorani/>

¹¹ Shiko dokumentin në link-un: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/nees/this-article-is-available-only-in-albanian-238/>

disa të tjerë u shkarkuan me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar. Të vetmit gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese që është në detyrë, zonjës Vitore Tusha, i ka përfunduar mandati që prej muajit mars 2017, por që sipas nenit 125/3 të Kushtetutës, ka zgjedhur të qëndrojë në detyrë deri në pritjen e zëvendësuesit të saj. Ky vend vakant i përket për plotësim Gjykatës së Lartë.

Janari i vitit 2019 e gjeti Gjykatën Kushtetuese me 9 vakanca të detyrueshme ligjërish për t'u plotësuar, të cilat tashmë ishin shpallur nga organet e emërtesës (President, Kuvend, Gjykata e Lartë) dhe që u trashëguan nga KED 2018, për shqyrtim dhe vlerësim sipas ligjit.

Nga listat e kandidatëve që kishin aplikuar në këto vakanca, ishin paraqitur një numër prej mbi 48 kandidatësh, ndërkohë që u vërejt se një numër i konsiderueshëm i kandidatëve kishin aplikuar në disa vakanca njëherazi.

Sipas raportimit të KED-së, për tre vendet vakante që i përkisnin për plotësim Gjykatës së Lartë, edhe pas rishpalljes së procedurave të aplikimit në datë 19.04.2019, për shkak të mungesës së kandidatëve, për të tre këto vende vakante nuk është bërë i mundur sigurimi i një liste me së paku 3 kandidatë. Në këtë mënyrë KED, ka operuar me shqyrtimin e praktikave për plotësimin e vetëm 6 vakancave në Gjykatën Kushtetuese, që i përkisnin 3 Presidentit të Republikës dhe 3 Kuvendit të Shqipërisë.

Brenda vitit 2019, KED mundi të përmbyllte verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve vetëm për 4 vende vakante, me mandat të plotë, ku konkuronin 37 kandidatë.

Dy vende vakante, u krijuan nga përfundimi i mandatit të dy ish-gjyqtarëve Sokol Berberi dhe Vladimir Kristo, të cilëve u përfundoi mandati në vitin 2016, ku një vakancë i përkiste Presidentit për plotësim dhe një Kuvendit. Ndërkohë dy vakanca të tjera u krijuan për shkak të përfundimit të mandatit të rregullt në maj 2019 që i përkisnin dy ish-gjyqtarëve Altina Xhoxhaj dhe Bashkim Dedja, ku edhe këtu, një i përket Presidentit dhe një Kuvendit për plotësim.

Ndërkohë, KED, nuk mundi të përmbyllë shqyrtimin e kandidaturave për vakancat e tjera të parakohshme që i përkisnin Presidentit dhe Kuvendit për plotësim.

V. Procedurat e ndjekura nga KED për verifikimin e kandidatëve, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe proceset gjyqësore.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2019, pas përfundimit të miratimit të akteve nënligjore në Prill 2019 filloi zyrtarisht procesin e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për të gjitha 6 vendet vakante që i përkisnin për plotësim Presidentit dhe Kuvendit.

Brenda vitit 2019, KED mundi të përmbyllte verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve vetëm për 4 vende vakante, me mandat të plotë, ku konkuronin 37 kandidatë, ndërkohë për dy vakanca të tjera nuk u përmbyll shqyrtimi. Përgjatë procesit të verifikimit të të gjithë kandidatëve 15 kandidatë u dorëhoqën nga gara gjatë fazës së verifikimit, ndërkohë që 20 kandidatë të tjerë u ndaluan me vendim të KED për të vijuar kandidimin.

Ndërkohë përgjatë muajve qershor- korrik 2019, si rezultat i vendimeve të KED, një pjesë e kandidatëve iu drejtuan Gjykatës së Apelit Administrativ, duke kundërshtuar vendimet e skualifikimit, me pretendimin se ishin skualifikuar padrejtësisht nga kandidimi nga KED.

Gjykata e Apelit Administrativ në shqyrtim të dy vendimeve të KED, për skualifikimin e një kandidati nga gara për dy vende vakante, konstatoi se disa veprime procedurale, apo vlerësime të KED që i përkasin momenteve më të rëndësishme të këtij procesi, janë **kryer në shkelje të rëndë të procedurës së përcaktuar nga ligji, me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të KED.** Gjykata e Apelit Administrativ me **vendimin nr. 201, datë 22.08.2019**¹², vendosi shfuqizimin e dy vendimeve të KED, dhe rikthimin e çështjes për rigjykim në Këshill.

Në datë **31 gusht 2019, Presidenti i Republikës**, me shkresën **nr. 2941/1 Prot., datë 31.08.2019**¹³, i është drejtuar KED, **duke kërkuar zbatimin me rigorozitet të Kushtetutës dhe ligjit, dhe me kërkesën që Këshilli, të tregojë shumë kujdes përgjatë veprimtarisë së tij, pasi çdo problematikë apo mangësi, cenon së pari besimin e publikut, të vetë kandidatëve, të organeve të emërtesës, tek vetë procesi, por njëkohësisht përbën shkelje të parimit për një proces të rregullt ligjor.**

Presidenti i Republikës, në shkresën e mësipërme, i kërkon KED, ndër të tjera se:

“Kjo gjendje emergjence e krijuar subjektivisht për shkak të bllokimit dhe mosfunksionimit të Këshillit përgjatë viteve 2017-2018, nuk mund të tolerojë faktin që KED aktual, për çështje të caktuara të bëjë interpretime të zgjeruara dhe krijuese, përtej kompetencave që i parashikon Kushtetuta dhe ligji, sidomos po të mbahet parasysh që kërkesat e organeve të emërtesës për plotësimin e vendeve vakant daton që prej muajit shkurt-mars 2018.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësisë duhet t’u përmbahet kërkesave të Kushtetutës dhe ligjeve për të **garantuar organet e emërtesës (Presidentin, Kuvendin, Gjykatën e Lartë), si dhe gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë se kandidatët e verifikuar, kualifikuar, vlerësuar dhe të listuar prej tij kanë cilësitë më të larta profesionale dhe morale për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese apo dhe Inspektor i Lartë i Drejtësisë.***

Presidenti i Republikës vlerëson të sjellë në vëmendje të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi se për rolin dhe rëndësinë që ka Gjykata Kushtetuese në mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës, është e nevojshme që kjo hallkë e rëndësishme dhe unike e drejtësisë kushtetuese të jetë sa më shpejt funksionale.

¹² Për më shumë, shiko vendimin e Gjykatës, në link-un:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/vendim_nr_201_dt_22_08_2019_zhaklina_peto_2208.pdf

¹³ Shiko bashkëlidhur letrën e Presidentit të Republikës Nr. 2941/1 Prot., datë 31.08.2019, drejtuar KED.

Presidenti inkurajon Këshillin e Emërimeve në Drejtësi që në bashkëpunim me organet e ngarkuara nga ligji të realizojë në një kohë sa më të shpejtë përmbushjen e detyrave funksionale për verifikimin, vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, sipas kërkesave të Kushtetutës dhe ligjit, duke përcjellë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, listat me numrin e nevojshëm të kandidaturave të vlerësuara dhe renditura për secilën vakancë, për të bërë të mundur që organet e emërtesës të kenë mundësi të zgjedhin sa më shpejt dhe sipas radhës, anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që kjo Gjykatë të jetë sa më shpejt funksionale për të marrë vendime dhe për t'i dhënë zgjidhje një sërë çështjeve që shqetësojnë të gjithë jetën shoqërore në vend”.

VI. Procedurat e KED për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

Në muajin shtator KED përfundoi procesin e verifikimit të kandidatëve për 4 vende vakante, dhe në garë mbetën vetëm 6 kandidatë, ku shumica prej tyre konkurronin në të katër vakancat njëkohësisht.

KED në datë **21.09.2019** ka miratuar me katër vendimmarrje të ndryshme listat përfundimtare, renditjen e kandidatëve dhe raportet e vlerësimit për kandidatët e lejuar që konkurrojnë në të 4 (katër) vakancat e shpallura që u përkasin për emërim/zgjedhje si organ emërtese Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe që paraqiten si më poshtë:

- 1. Vendimi nr. 128, datë 21.09.2019 dhe vendimi nr. 129, datë 21.09.2019** me të cilat u miratua Lista Përfundimtare, Renditja e Kandidatëve dhe Raporti i Arsyetuar për plotësimin e vendit të shpallur për aplikim nga **Presidenti i Republikës** në datën 07.02.2018.
- 2. Vendimi nr. 130, datë 21.09.2019 dhe vendimi nr. 131, datë 21.09.2019** me të cilat u miratua Lista Përfundimtare, Renditja e Kandidatëve dhe Raporti i Arsyetuar për plotësimin e vendit vakant të shpallur për aplikim nga **Kuvendi i Shqipërisë** në datën 12.02.2018.
- 3. Vendimi nr. 132, datë 21.09.2019 dhe vendimi nr. 133, datë 21.09.2019** me të cilat u miratua Lista Përfundimtare, Renditja e Kandidatëve dhe Raporti i Arsyetuar për plotësimin e vendit vakant të shpallur për aplikim nga **Presidenti i Republikës** në datën 04.03.2019.
- 4. Vendimi nr. 134, datë 21.09.2019 dhe vendimi nr. 135, datë 21.09.2019** me të cilat u miratua Lista Përfundimtare, Renditja e Kandidatëve dhe Raporti i Arsyetuar për plotësimin e vendit vakant, të shpallur për aplikim nga **Kuvendi i Shqipërisë** në datën 04.03.2018

Siç e kërkon ligji nr. 115/2016, këto vendime u publikuan në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Referuar sistemit të numërimit të vendimeve, rezulton se KED, si organ kolegjal, ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime të posaçme për secilën vakancë të shpallur dhe ka miratuar listën përfundimtare të renditjes për çdo vakancë të shpallur nga organet e emërtesës, **duke respektuar radhën që duhet të ndiqet për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj kushtetues, të**

parashikuar në nenin 179 pika 2, 12 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, dhe 86 pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Renditjen e kandidatëve dhe krijimin e 4 listave, për të dy institucionet - President i Republikës dhe Kuvend, KED i ka bërë më 21.09.2019, dhe numërtimi i vendimeve është i alternuar sipas radhës që dikton Kushtetuta dhe ligji, dhe radhës së shpalljes dhe plotësimit të vakancave që i përkasin për plotësim Presidentit dhe Kuvendit.

Renditja e kandidatëve për secilën vakancë miratuar nga KED:

PRESIDENTI <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>07 Shkurt 2018</i>	KUVENDI <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>12 Shkurt 2018</i>	PRESIDENT <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>4 Mars 2019</i>	KUVENDI <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>4 Mars 2019</i>
KANDIDATËT E RENDITUR NGA KED	KANDIDATËT E RENDITUR NGA KED	KANDIDATËT E RENDITUR NGA KED	KANDIDATËT E RENDITUR NGA KED
1. Arta Vorpsi 2. Elsa Toska 3. Besnik Muçi 4. Regleta Panajoti	1. Arta Vorpsi 2. Elsa Toska 3. Besnik Muçi	1. Arta Vorpsi 2. Fiona Papajorgj 3. Elsa Toska 4. Marsida Xhaferllari	1. Arta Vorpsi 2. Fiona Papajorgji 3. Elsa Toska

Në këtë mbledhje (21 shtator 2019), Përfaqësuesi i Presidentit të Republikës kërkoi që KED të respektojë edhe radhën e dërgimit të listave për secilin nga organet e emërtesës për të mos krijuar vështirësi dhe problematikë në këtë proces. Ndërsa Avokati i Popullit evidentoi se me këtë numër të kufizuar kandidatësh dhe me përsëritjen e emrave të njëjtë në secilën prej listave, KED po paracaktonte përbërjen e Gjykatës Kushtetuese dhe se organeve të emërtesës po u kufizohej e drejta e zgjedhjes.

VII. Procedura antikushtetuese dhe antiligjore e dërgimit të listave prej Kryetarit të KED, tek organet e emërtesës (President, Kuvend).

Kryetari i KED, i përcolli listat e kandidatëve në adresë të Presidentit të Republikës për plotësimin e 2 (dy) vakancave *njëherazi*¹⁴, datë 8 tetor 2019, me shkresë nr. 552 prot. dhe me shkresë nr. 553 prot.

¹⁴ Për më shumë, shiko shkresat me nr. 552 prot., datë 08.10.2019 dhe me nr.553 prot., datë 08.10.2019, të Kryetarit të KED-së.

KED nuk ka marrë asnjë vendim kolegjal, për ndryshimin e mënyrës dhe kohës së dërgimit të listave pranë organeve të emërtesës. Veprimi administrativ i përcjelljes së listave tek organet e emërtesës, ndryshe nga sa kishte miratuar KED, është kryer në mënyrë individuale nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili sipas nenit 226 pika 2/e, e ligjit nr. 115/2016, ka si funksion vetëm të nënshkruajë aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe t'ia përcjellë ato organit të emërtesës.

Në datë 10 tetor 2019, Presidenti i Republikës, nisur nga fakti që të njëjtët aplikantë gjendeshin si në listat e dërguara për Presidentin ashtu dhe në ato të miratuara për Kuvendin, në zbatim të parimit të luajalitetit kushtetues (bashkëpunimit) dhe me qëllim që përzgjedhja e gjyqtarit kushtetues prej tij të mos cenonte numrin e kandidatëve që do t'i përcilleshin Kuvendit të Shqipërisë, **me shkresë nr. 3571 prot., datë 10.10.2019**¹⁵, i kërkoi Kryetarit të KED informacion nëse ia kishte përcjellë ose jo, Kuvendit të Shqipërisë listat e kandidatëve për dy vendet vakante. Një përzgjedhje e mundshme e Presidentit, pa ruajtur radhën kronologjike që Kushtetuta përcakton, mund të sillte teorikisht, deri edhe në vendosjen e Kuvendit në kushtet e pamundësisë praktike për të pasur numrin e nevojshëm të kandidatëve për të zgjedhur anëtarët që i takojnë.

Kryetari i KED me shkresën nr. 655 prot., datë 14 tetor 2019, informoi Presidentin e Republikës se: *“Ditën e sotme me shkresën nr.653 prot., datë 14.10.2019 dhe me shkresën nr. 654 prot., datë 14.10.2019, ka përcjellë dhe ka dorëzuar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Listat Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e 2 (dy) vakancave njëherazi nga Kuvendi i Republikës”*¹⁶.

Pra Kryetari i KED, në datën 14 tetor 2019, (vetëm pas 6 ditëve nga dërgimi i listave pranë Institucionit të Presidentit) ka realizuar procesin administrativ të dërgimit të listave në Kuvend, për plotësimin e të dy vakancave njëherazi, që i përkasin Kuvendit për zgjedhje. Në përgjigjen e dhënë Kryetari i KED, nuk paraqiti asnjë shpjegim se cilat ishin arsyet e dërgimit të dy listave njëherazi tek Presidenti, dhe cilat ishin shkaqet e vonës dhe të dërgimit të dy listave njëherazi me një javë diferencë pranë Kuvendit. Këto veprime administrative individuale të Kryetarit të KED nuk respektonin as kohën dhe as radhën e përpilimit e miratimit të listave, dhe as rendin kronologjik të detyrueshëm, që ka caktuar Kushtetuta dhe ligji, për plotësimin e çdo vendi vakant.

Kjo situatë e krijuar, e diktuar nga momenti i dërgimit të listave prej Kryetarit të KED do të përkonte me faktin që sipas Kryetarit të KED, Presidenti do të duhej të shprehej brenda datës 7 nëntor 2019 për të emëruar **dy gjyqtarë** të Gjykatës Kushtetuese njëherazi, **ç’ka përbën ndalim të drejtpërdrejtë nga neni 179, pikat 2, 12 të Kushtetutës dhe nenet 7, 7/b dhe 86, pikat 4/a/c të ligjit nr. 8577/2000.**

¹⁵ Për më shumë, shiko shkresën me nr. 3571 prot., datë 10.10.2019, të Institucionit të Presidentit të Republikës.

¹⁶ Për më shumë, shiko shkresën me nr. 655 prot., datë 14.10.2019, të Kryetarit të KED-së.

Në nenin 179 pikat 2 dhe 12 të Kushtetutës, përcaktohet:

“2. Anëtari i parë për t’u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. [...]

12. Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2, të këtij neni, dhe nenit 125 të Kushtetutës.”

Sipas këtyre dispozita të Kushtetutës, Presidenti i Republikës, nuk mund të emërojë **dy gjyqtarë njëherazi, apo dy gjyqtarë njëri pas tjetrit**, por vetëm anëtarin e parë, ndërkohë që anëtari i dytë i Gjykatës Kushtetuese duhet të emërohet nga Kuvendi dhe i treti nga Gjykata e Lartë.

Në rastin konkret, anëtari që do të duhej të emërohej nga Gjykata e Lartë, do të zëvendësonte gjyqtaren zonjën Vitore Tusha, së cilës, sipas Kushtetutës, i ka përfunduar mandati që prej muajit mars 2017, por është në detyrë në pritje të pasardhësit.

Secili prej organeve të emërtesës ka në dispozicion 30-ditë kohë për t’u shprehur. Për Kuvendin ky afat është i përcaktuar në nenin 125 të Kushtetutës, ndërkohë që për Presidentin ky afat është i përcaktuar vetëm në ligjin nr. 8577/2000, neni 7/b, pika 4.

Sipas momentit të dërgimit të listave nga Kryetari i KED në shërbim të skenarit rrëmbyes, afati për Presidentin, kishte filluar të ecte njëkohësisht për të dy vakancat prej datës 9.10.2019 dhe për Kuvendin afati kushtetues kishte filluar të ecte njëkohësisht për të dy vakancat prej datës 15.10.2019.

Në këtë mënyrë, Kryetari i KED me përcjelljen e njëkohshme të listave të kandidatëve për plotësimin e të dy vakancave që i përkasin Presidentit të Republikës, synoi ta vendoste Presidentin e Republikës në pamundësi kushtetuese, duke u përpjekur që të krijojë një gjendje të faktit të kryer, ku Presidenti do të duhej të shprehej brenda afatit ligjor 30-ditor (neni 7/b, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000) edhe për emërimin e gjyqtarit tjetër, eventualisht përpara se Kuvendi të shprehej për emërimin e gjyqtarit të dytë kushtetues. Kjo do të përbënte shkelje të drejtëpërdrejtë të Kushtetutës nga Presidenti.

VIII. Emërimi nga Presidenti i Republikës, i gjyqtarit të parë të Gjykatës Kushtetuese.

Presidenti i Republikës pasi shqyrtoi praktikën dhe dokumentacionin e përcjellë në datën 08.10.2019 nga KED, si dhe pasi u sigurua që Kuvendi administroi listat me kandidatë nga KED, përmbushi pa vonesë detyrimin kushtetues, për zgjedhjen dhe emërimin e **anëtarit të parë** të Gjykatës Kushtetuese.

Me dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019¹⁷, zoti Besnik Muçi, u emërua anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Në arsyet që shoqërojnë Dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019, Presidenti i Republikës, ndër të tjera ka evidentuar se: *“Duke vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin dhe rëndësinë që ka Gjykata Kushtetuese në mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës, Presidenti i Republikës ka vendosur që të shprehet pa vonesë për emërimin e kandidatit të përzgjedhur prej tij, në mënyrë që kjo vendimarrje të pasohet me një vendimarrje të Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjen e anëtarit tjetër të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që Gjykata Kushtetuese të jetë sa më shpejt funksionale e aftë për të marrë vendime dhe për t’i dhënë zgjidhje kushtetuese një sërë çështjeve që shqetësojnë të gjithë jetën shoqërore në vend”*.

Me këtë akt, Presidenti i Republikës, veç të tjerave në zbatim të parimit të luajalitetit kushtetues, ka kërkuar bashkëpunimin e Kuvendit, që ky i fundit të zgjedhë anëtarin e dytë, e më pas Presidenti të vijonte me zgjedhjen e anëtarit tjetër sipas radhës që dikton Kushtetuta.

Ky dekret dhe arsyet e tij, u publikuan në faqen zyrtare të Presidentit të Republikës¹⁸ dhe përmes mjeteve të informimit publik, dhe iu përcoll me shkresën nr. 3665 prot., datë 16.10.2019, për njoftim Kryetarit të Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit, Këshillit të Larë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ndërkohë menjëherë Presidenti i Republikës, në datë 18.10.2019, organizoi ceremoninë e betimit të këtij gjyqtari ku u ftuan për të marrë pjesë të gjitha institucionet e mësipërme dhe përfaqësues diplomatikë¹⁹. Pas këtij momenti, gjyqtari Besnik Muçi filloi ushtrimin e mandatit.

IX. Vendimarrja e Presidentit të Republikës për pezullimin e përkohshëm të procesit të shqyrtimit administrativ të listës dhe dokumentacionit për plotësimin e vendit vakant për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Pas emërimit të gjyqtarit të parë kushtetues, Presidenti i Republikës ka qenë në pritje të vendimarrjes së Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese, sipas radhës që dikton Kushtetuta në nenin 179, pikat 2 e 12, dhe ligji nr. 8577/2000, në nenet 7/a dhe 86 pika 4.

Ky rregull, i parashikuar në Kushtetutë dhe i përforcuar disa herë në ligjin nr. 8577/2000 të Gjykatës Kushtetuese është thelbësor për t’u respektuar jo vetëm nga ana e institucioneve

¹⁷ Për më shumë, shiko Dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019 dhe arsyetimin që shoqëron këtë dekret.

¹⁸ Për më shumë, shiko link-un: <https://president.al/presidenti-meta-dekreton-emerimin-e-zotit-besnik-muci-gjyqtar-te-gjykat-es-kushtetuese/>

¹⁹ Për më shumë, shiko link-un: <https://president.al/en/?s=besnik+muci+betohet>

përkatëse (President, Kuvend, Gjykatë e Lartë), **por duhej të respektohej dhe nga Kryetari i KED në procesin fundor të veprimit administrativ të përcjelljes së listave.** Kjo për shkakun e thjeshtë ligjor, se e drejta e secilit prej institucioneve për emërimin/zgjedhjen, duhet të shterohet vërtet brenda një afati 30-ditor, **por nga ana tjetër, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm në kushtet kur nuk ka një ndalim kushtetues që e pengon atë.**

Sipas kohës së dërgimit të listave prej Kryetarit të KED, Kuvendi mund të zgjidhte (ashtu siç dhe ndodhi) të shprehej për zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese brenda datës **13 nëntor 2019**, që përkon me plotësimin e afatit 30-ditor që neni 125, pika 2, e Kushtetutës i përcakton si afat kushtetues.

Duke qenë se ecja e afatit 30-ditor për Presidentin e Republikës përcaktohet **vetëm në nenin 7/b, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000, merrte përparësi respektimi i dispozitës kushtetuese mbi radhën kronologjike të emërimit që ka përcaktuar Kushtetuta, por që ka qartësuar në mënyrë shteruese edhe vetë ligji.**

Kuvendi nuk shfaqti asnjë bashkëpunim, por i shkoi deri në fund skenarit të parapërgatitur për t'u shprehur në kufi të afatit 30-ditor, dhe për ta vendosur Presidentin në kushtet e pamundësisë kushtetuese për të emëruar anëtarin e tij të Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimit të radhës kushtetuese.

Në këto kushte, Presidenti shqyrtoi situatën dhe arriti në përfundimin se shqyrtimi në themel i propozimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vakancën tjetër që plotësohej prej tij, nuk mund të realizohej në atë moment, pasi sipas nenit 179, pikat 2 dhe 12 të Kushtetutës, si dhe neneve 7, pika 2, dhe 86, pika 4/a/c, të ligjit nr. 8577/2000, **ishte përpara një ndalimi kushtetues sepse ishte radha e Kuvendit të Shqipërisë që të shprehej për zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese.**

Nëse Presidenti i Republikës do të vepronte sipas propozimit të Kryetarit të KED, (dhe jo të organit kolegjal KED), duke emëruar dy gjyqtarë njëherazi ai shkelte drejtpërdrejt dy dispozita të Kushtetutës dhe disa dispozita të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Ky veprim do të legjitimonte më pas mazhorancën socialiste ta akuzonte Presidentin për shkelje të Kushtetutës.

Njëkohësisht, nëse Presidenti sapo administroi listat prej KED, do të zgjidhte menjëherë dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, do të cenonte në thelb të drejtën e Kuvendit “për të zgjedhur”, pasi listat e kandidatëve të Kuvendit do të zbrisnin nën minimumin e kandidatëve që lejon Kushtetuta.

Kryetari i KED, sipas skenarit të përgatitur nga mazhoranca socialiste për t'i imponuar Presidentit kandidatët e saj të paracaktuar, qëllimisht nuk iu përmbajt këtyre

parashikimeve kushtetuese, dhe ngriti kurthin procedural me dërgimin e listave në kohë të ndryshme për të dy Institucionet, duke bashkuar vakancat jashtë radhe.

Për të ruajtur kushtetutshmërinë e procesit dhe me qëllim që të ushtronte të drejtën e tij kushtetuese për emërimin e gjyqtarit kushtetues, Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 4, 92, 179, pikat 2, 12 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/b, dhe 86 pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 66 dhe 44/2 shkronja “c” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nëpërmjet **Aktit Administrativ nr. 3535/1 Prot, datë 05.11.2019²⁰**, vendosi:

- ***Të pezullojë procesin administrativ të shqyrtimit të listës dhe praktikës dokumentare për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, e shpallur nga Presidenti i Republikës me dekretin nr.11133, datë 04.03.2019, përcjellë nga KED me shkresë nr. 553 prot., datë 08.10.2019, deri në zgjedhjen e anëtarin e dytë të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi i Shqipërisë apo deri në përfundimin e afatit kushtetues, brenda të cilit Kuvendi i Shqipërisë do të shprehet për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e dy vakancave që i përkasin atij si organ emërtese dhe që, sipas përlllogaritjes, ky afat përmbushet në datë 13 nëntor 2019;***
- ***T’i kërkojë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm plotësimin e praktikës dokumentare dhe dërgimin brenda 5 (pesë) ditëve të kopjes së dokumentacionit të administruar e të shqyrtuar nga KED që përmban dosja e kandidimit e secilit prej 4 (katër) kandidatëve të lejuar dhe të listuar nga KED për plotësimin e vakancës së shpallur nga Presidenti me dekretin nr.11133, datë 04.03.2019, me qëllim vijimin e shqyrtimit;***
- ***Të kërkojë bashkëpunimin e Kuvendit të Shqipërisë që të vlerësojë mundësinë për të përfshirë për shqyrtim në seancë plenare, brenda një kohe sa më të shpejtë, zgjedhjen e anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që Presidenti i Republikës, të ushtrojë kompetencën e tij, sipas radhës së diktuar nga Kushtetuta dhe ligji nr.8577/2000.***

Ky vendim iu përcoll menjëherë Kryetari të Kuvendit, Avokatit të Popullit dhe KED.

Në aktin e pezullimit, Presidenti i Republikës ka shprehur qartë se në cilësinë e organit të emërtesës, Presidenti ka të gjithë vullnetin dhe do të shprehet për të emëruar anëtarin e radhës të Gjykatës Kushtetuese nga lista e kandidaturave të përcjella nga KED. Shprehja e vullnetit prej Presidentit publikisht dhe zyrtarisht se do të zgjedhë me dekret emërimin e gjyqtarit kushtetues, dhe akti administrativ nr. 3535/1 prot, datë 05.11.2019, janë akte që tregojnë se mekanizmi zhblllokues në këtë rast, i parashikuar në nenin 7/b, pika 4 e ligjit nr. 8577/2000, është i pa aplikueshëm. Nga fryma dhe gërma e ligjit, është e qartë se ky mekanizëm mund të aplikohet vetëm në ato raste kur organi i emërtesës nuk shprehet, pra vendos të qëndrojë në heshtje.

²⁰ Për më shumë, shiko aktin administrativ nr. 3535/1 Prot, datë 05.11.2019, të Presidentit të Republikës.

X. Mbledhje e KED, datë 7 nëntor 2019 mbi vendimmarrjen e Presidentit të Republikës për pezullimin e përkohshëm administrativ të shqyrtimit të listës dhe dërgimi i akteve plotësuese prej KED.

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi është njohur me aktin në datën 6 Nëntor 2019, ka njoftuar thirrjen e mbledhjes së KED në datën 7 Nëntor 2019, me rend dite "*Diskutim mbi qëndrimet e Presidentit të Republikës, lidhur me procesin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese*".

Në këtë mbledhje, përveç anëtarëve të KED-së, qenë të pranishëm përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesi i Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë. **Anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje dakordësuan se nuk mund të komentojnë përmbajtjen e letrës së Presidentit me argumentin se nuk kanë autoritet që të diskutojnë vendimin e Presidentit.**

Anëtarët e KED, gjithashtu dakordësuan se interpretuesi i parë i një kompetence kushtetuese është vetë organi kushtetues dhe secili organ kushtetues bën interpretimin e normës apo të kompetencës së tij në mënyrë ose në përputhje me vullnetin e tij, pa u angazhuar nga organet e tjera.

Anëtarët e KED gjithashtu evidentuan në mbledhje se KED e ka përfunduar vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për secilën vakancë që prej datës 21 shtator 2019 dhe dërgimi i listave tek organet e emërtesës është veprimtari administrative e Kryetarit të KED dhe nuk kërkon vendimmarrje të KED. Avokati i Popullit prezent në mbledhje ka pyetur Kryetarin e KED, se përse janë përcjellë në këtë mënyrë, listat tek organet e emërtesës President- Kuvend (dy e nga dy dhe të diferencuara me 6 ditë njëra nga tjetra), por Kryetari i KED, nuk ktheu një përgjigje mbi këtë çështje. Këshilli në mbledhjen e datës 7 nëntor 2019, vendosi *vetëm* përcjelljen e dokumentacionit shtesë të kërkuar Presidentit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në këtë mbledhje, datë 7 nëntor 2019, nuk diskutoi dhe nuk mori asnjë vendim për asnjë çështje tjetër.

Në këtë mbledhje, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, u bëri me dije edhe një herë anëtarëve të KED dhe përfaqësuesve të Kuvendit se, Presidenti ka vullnet dhe do të shprehet për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese që i takon për plotësim Presidentit të Republikës, pa asnjë vonesë, sapo Kuvendi të shprehet për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e vakancës së dytë në Gjykatën Kushtetuese²¹.

²¹ Shiko përmbledhjen e procesverbalit të mbledhjes së KED, datë 7.11.2019, në link-un: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Procesverbale_te_mbledhjeve_5601_1.php.

Në të njëjtën ditë, pas përfundimit të mbledhjes së KED, Kryetari i KED me shkresën nr. 714 prot, datë 07.11.2019, i është përgjigjur Presidentit, duke përcjellë praktikën dokumentare të administruar dhe vlerësuar nga KED për të 4 (katër) kandidatët e listuar për plotësimin e vendit vakant nga Presidenti i Republikës.

XI. Caktimi i seancës plenare për votimin e kandidatëve të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, pasi është njohur me aktin e pezullimit nr. 3535/1 prot., datë 05.11.2019 të Presidentit për pezullimin e përkohshëm administrativ të shqyrtimit të listës, **dhe për koencidencë në të njëjtën ditë me zhvillimin e mbledhjes së KED, në datë 7 nëntor 2019**, nxori urdhrin nr. 35, datë 7.11.2019, “Për mbledhjen e Kuvendit në Seancë Plenare në datën 11.11.2019”²².

Në rendin e ditës në seancën plenare të datës 11 nëntor 2019 u përfshinë dhe dy projektvendime për zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për vakancat e shpallura nga Kuvendi. Kuvendi i Shqipërisë nuk iu përgjigj kërkesave të përsëritura të Presidentit të Republikës për të votuar në seancë plenare vetëm anëtarin e dytë, sipas radhës që përcakton Kushtetuta, në mënyrë që Presidenti të shprehej më pas për zgjedhjen e anëtarit tjetër.

XII. Botimi në kundërshtim me ligjin në Fletoren Zyrtare i Vendimit nr. 132, datë 21 shtator 2019 i KED.

Ditën e shtunë (pushim) datë 9 nëntor 2019, në **Fletoren Zyrtare**²³ nr. 151, u botua vendimi i KED nr. 132, i datës 21 shtator 2019 “*Për miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019*”.

Në fakt, ky vendim ishte botuar që prej datës 22 shtator 2019 në faqen e Gjykatës së Lartë, siç parashikon vet vendimi kolegjal i KED, në pikën 2 të tij, ku citon se: “**Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi**”; dhe siç parashikon ligji nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë*” neni 232, që përcakton se: “aktet e vlerësimit dhe të renditjes publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë”.

²² Për më shumë, shiko link-un: <https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=3764>

²³ Botimi apo mosbotimi në Fletoren Zyrtare në kundërshtim me ligjin, është kthyer tashmë në traditë nga mazhoranca socialiste për realizimin e qëllimeve politike. Kujtojmë se edhe rasti i qëndrimit në detyrë të Kryetarit të KED Ardian Dvorani përtej mandatit kushtetues u realizua pikërisht nëpërmjet mosbotimit në kohë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në fletoren zyrtare. **Keqpërdorimi i Fletores Zyrtare** u konstatua edhe nga **OSBE/ODIHR** në raportin mbi procesin e votimeve të **30 qershorit 2019**.

Ligji nr.78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare” dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, **nuk e përcaktojnë këtë vendim në llojin e akteve që botohen në Fletoren Zyrtare.** Po kështu, nuk kishte asnjë vendimarrje të KED për botimin e listës për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në Fletoren Zyrtare.

Dërgimi për botim në Fletore Zyrtare i këtij akti nga Kryetari i KED Ardian Dvorani synoi të krijonte idenë e rreme se KED e pati diskutuar këtë çështje në mbledhjen e datës 7 nëntor 2019 dhe pati vendosur publikimin në Fletoren Zyrtare të vendimit të tij nr. 132, datë 21 shtator 2019, në funksion të mekanizmit zhbllokues që parashikon ligji. **Ky qe një tjetër inskenim nga Ardian Dvorani, pasi në të vërtetë, KED as në mbledhjen e datës 7 nëntor 2019, dhe as në ndonjë mbledhje tjetër, nuk mori ndonjë vendim të kësaj natyre dhe as ka diskutuar mbi këtë çështje.**

Presidenti i Republikës, duke e konsideruar këtë veprim të Kryetarit të KED, si shkelje të hapur dhe me dashje të ligjit, në datë 19 nëntor 2019, ka paraqitur **Kallzim Penal ndaj zotit Ardian Dvorani Kryetar i KED, aktualisht nën hetim nga struktura e posaçme antikorruption (SPAK)**²⁴.

Botimi në Fletoren Zyrtare nga Kryetari i KED- Ardian Dvorani dhe Qeveria Shqiptare, u bë në mënyrë të paramenduar dhe të organizuar bashkarisht. Ky akt do të përdorej më pas nga Kuvendi, në seancën plenare të datës 11 nëntor 2019, për të emëruar *apriori* kandidaten e paracaktuar, znj. Arta Vorpsi (e renditur po ashtu qëllimisht e para në të 4 listat), si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, duke konsideruar të përfunduar afatin ligjor 30-ditor të Presidentit të Republikës për t’u shprehur.

Nënvizojmë se, Akti Administrativ i Presidentit të Republikës nr. 3535/1 Prot, datë 05.11.2019, nuk u kontestua përpara asnjë gjykate nga asnjë prej palëve të përfshira në proces apo palëve të interesuara.

XIII. Shkeljet kushtetuese të Kuvendit të Shqipërisë në procesin e përzgjedhjes së dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Kuvendi i Shqipërisë u mbledh në seancë plenare në datë 11 nëntor 2019, ora 10:00. Sipas rendit të ditës së miratuar, në seancën plenare të datës 11 nëntor 2019 u përfshinë dhe dy projektvendime për zgjedhjen e **dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese**, për vakancat e shpallura nga Kuvendi.

²⁴ Shiko kallëzimin penal bashkëlidhur të depozituar në Prokurorinë SPAK, ose në link-un: <https://president.al/presidenti-meta-kallezon-penalisht-kryetarin-e-keshillit-te-emerimeve-ne-drejttesi-z-ardian-dvorani/>

Lista e Kandidatëve që kishte në dispozicion Kuvendi për të zgjedhur:

KUVENDI <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>12 Shkurt 2018</i>	KUVENDI <i>Vakanca e shpallur për aplikim</i> <i>4 Mars 2019</i>
RENDITJA	RENDITJA
1. Arta Vorpsi 2. Elsa Toska 3. Besnik Muçi (zoti Muçi kishte humbur cilësinë e kandidatit pasi ishte zgjedhur gjyqtar i GJ.K nga Presidenti që prej 15 tetor 2019)	1. Arta Vorpsi 2. Fiona Papajorgji 3. Elsa Toska

Kur Kuvendi dukej se po shkonte drejt një procesi përzgjedhës për të votuar dy anëtarë njëherazi të Gjykatës Kushtetuese, në shkelje të parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, sërish Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja “a” të Kushtetutës, nëpërmjet një mesazhi publik drejtuar deputetëve të Kuvendit, 2 orë përpara zhvillimit të seancës plenare, kërkoi edhe një herë bashkëpunimin e deputetëve të Kuvendit, për respektimin dhe ruajtjen e kushtetutshmërisë së të gjithë procesit. Mesazhi i Presidentit drejtuar Kuvendit ishte²⁵:

“Të nderuar deputetë,

Sot është një ditë tepër e rëndësishme për të treguar përgjegjshmëri për të ardhmen europiane të Shqipërisë!

Ju e dini që krijimi i Gjykatës Kushtetuese është një nga nëntë kushtet kryesore të Bundestagut gjerman për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian.

Kushtetuta e ka përcaktuar qartë radhën se si kryhen emërimet për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese!

Presidenti i Republikës e zgjodhi anëtarin e parë të saj menjëherë!

Tani është radha e Kuvendit të zgjedhë anëtarin e dytë, edhe pse me vonesë!

Presidenti po e ndjek me vëmendje këtë proces dhe do të shprehet menjëherë brenda 24 orëve për të zgjedhur anëtarin e tretë sapo Kuvendi të ketë shprehur vullnetin e tij.

²⁵ Për më shumë, shiko linqet:

[-https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/2601856493193941](https://www.facebook.com/ilirmetazyrtar/posts/2601856493193941)

[-https://www.rtsh.al/lajme/presidenti-meta-u-ben-thirrje-deputeteve-te-zgjedhin-anetarin-e-dyte-te-gjykatetes-kushtetuese/](https://www.rtsh.al/lajme/presidenti-meta-u-ben-thirrje-deputeteve-te-zgjedhin-anetarin-e-dyte-te-gjykatetes-kushtetuese/)

[-https://ata.gov.al/2019/11/11/zgjedhja-e-anetarit-te-kushtetueses-meta-thirrje-deputeteve-dite-teper-e-rendesishme/](https://ata.gov.al/2019/11/11/zgjedhja-e-anetarit-te-kushtetueses-meta-thirrje-deputeteve-dite-teper-e-rendesishme/)

[-https://360grade.al/308490/presidenti-meta-thirrje-deputeteve-po-e-ndjek-me-vemendje-lexoni-keto-nene-dhe-veproni-pa-humbur-kohe-sa-per-marifetet-e/](https://360grade.al/308490/presidenti-meta-thirrje-deputeteve-po-e-ndjek-me-vemendje-lexoni-keto-nene-dhe-veproni-pa-humbur-kohe-sa-per-marifetet-e/)

[-https://politiko.al/perplasja-per-anetaret-e-kushtetueses-meta-thirrje-deputeteve-para-seances-gjeni-5-minuta-kohe-lexoni-ligjin/](https://politiko.al/perplasja-per-anetaret-e-kushtetueses-meta-thirrje-deputeteve-para-seances-gjeni-5-minuta-kohe-lexoni-ligjin/)

*Ndaj ju lutem, gjeni pesë minuta kohë, lexoni nenin 179, pika 2 dhe 12 të Kushtetutës dhe nenin 86 pika 4/a/c të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe veproni pa humbur kohë!
Sa për marifetet e individëve të verbër partiakë të sistemit të drejtësisë dhe botimet kontrabandë në Fletoren Zyrtare, do t'i zbardhim për ju dhe publikun pak më vonë, bashkë me mbledhjet e pazbardhura të KED!!!”.*

Sërish Kuvendi nuk tregoi asnjë bashkëpunim me Presidentin. Përkundrazi, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, artikuluan në diskutimet e tyre se kandidatja e listuar e para si në listat e Kuvendit, ashtu dhe në listat e Presidentit, konsiderohej e zgjedhur në vakancën që i takon Presidentit, duke argumentuar *apriori* se ka funksionuar mekanizmi zhbllokues. Me këtë argument, por pa ndonjë akt, Kuvendi i Shqipërisë përjashtoi padrejtësisht nga votimi në seancë plenare kandidaten për anëtare të Gjykatës Kushtetuese zonjën Arta Vorpsi, e renditur e para.

Ky përjashtim nga procesi i votimit, pa ndonjë vendim të Kuvendit të Shqipërisë, përbën shkelje të rëndë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndaj kësaj kandidateje, pasi në këtë mënyrë asaj iu mohua pa të drejtë nga Kryetari i KED dhe Kuvendi e drejta për të marrë pjesë në garë. Kuvendi i Shqipërisë, në kundërshtim me çdo normë kushtetuese dhe jashtë kompetencave të tij, e konsideroi *apriori* të zgjedhur zonjën Arta Vorpsi në vakancën që i përket Presidentit të Republikës, edhe pse Kuvendi në praktikën e tij kishte administruar dhe ishte njohur me aktin administrativ nr.3535/1 prot, datë 05.11.2019 të Presidentit për pezullimin e procesit.

Ky veprim i Kuvendit, përbën shkelje të Kushtetutës, **me qëllim rrëmbimin e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese, që i takonte Presidentit të Republikës.**

Kuvendi në seancën plenare të datës 11 nëntor 2019, ka vijuar procesin e votimit **vetëm me një kandidate**. Me vendim nr. 133, datë 11.11.2019, zonja Elsa Toska është zgjedhur anëtare e Gjykatës Kushtetuese, **si e vetmja kandidate e mbetur në garë** për vakancën e shpallur nga Kuvendi për aplikim në datën 12.2.2018. Ky emërim është kryer në kundërshtim me nenin 125 të Kushtetutës, i cili dikton se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese përzgjidhen ndërmjet kandidateve të renditur në tri vendet e para të listës. Ndërsa emërimi i një kandidati të vetëm, nuk nënkupton asesi proces përzgjedhës në kuptim të kërkesave të Kushtetuës.

Pas kësaj, Kuvendi i Shqipërisë ka kaluar menjëherë në votimin për plotësimin e vakancës tjetër që sipas vlerësimit të tij, kishte mbetur përsëri **vetëm me një kandidate**. **Kuvendi sipas vlerësimit të tij**, e konsideronte zonjën Arta Vorpsi të zgjedhur, **ndërsa zonja Elsa Toska e zgjedhur në vakancën e tij të parë, humbi statusin e kandidatit**. Ndaj me vendimin nr. 134, datë 11.11.2019, Kuvendi zgjodhi **zonjën Fiona Papajorgji** anëtare të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e vakancës së shpallur për aplikim nga Kuvendi në datën 04.03.2019, si të vetmen kandidate të mbetur në garë.

Në këtë mënyrë:

- Kuvendi i Shqipërisë votoi në seancën plenare **njëherazi dy anëtarë** të Gjykatës Kushtetuese për plotësimin e dy vakancave, **në kundërshtim me radhën e caktuar në shkelje të parashikimeve të nenit 179, pika 2, 12 të Kushtetutës dhe neneve 7, 86, pika 4/a/c, të ligjit nr. 8577/2000;**
- Kuvendi i Shqipërisë, me vlerësimet *apriori* mbi numrin dhe statusin e kandidatëve në listat e administruara, krijoi një problematikë, pasi i mohoi pa të drejtë kandidates Arta Vorpsi, të drejtën për t'u votuar, për të konkurruar në mënyrë të lirë edhe për t'u zgjedhur;
- Kuvendi zgjodhi anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në kushtet kur në garë për secilën vakancë, sipas vlerësimit të tij, mbeti vetëm **1 kandidat i vlefshëm për përzgjedhje, në kundërshtim me nenin 125 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000;**
- Me votimin për dy kandidatë njëherazi dhe zgjedhjen e tyre si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ka cenuar edhe mundësinë e Presidentit të Republikës për zgjedhje, duke ulur numrin e kandidatëve të parashikuar në Kushtetutë nga 3 në 2 kandidatë;
- Me veprimtarinë e tij, Kuvendi humbi shansin të ndihmonte në ruajtjen e integritetit të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse Presidenti i Republikës i bëri thirrje në mënyrë të përsëritur;
- Edhe pse u kërkua në mënyrë zyrtare dhe me mesazhe publike të Presidentit, sërish Kuvendi nuk tregoi asnjë shenjë bashkëpunimi ndaj Institucionit dhe kërkesës së Presidentit, në kushtet kur ky bashkëpunim ishte me rëndësi, për shkak se kandidatët në listat e të dyja institucioneve ishin thujse të njëjtët emra;
- Vlerësimi apriori i Kuvendit se Presidentit i ka kaluar afati ligjor 30-ditor i përzgjedhjes së një kandidati, është i pambështetur në Kushtetutë. **Në Kushtetutë, ndryshe nga Kuvendi, për Presidentin e Republikës nuk ka asnjë afat të përcaktuar të detyrueshëm për t'u shprehur.**

XIV. Emërimi i gjyqtarit tjetër nga Presidenti i Republikës për vakancën e radhës.

Pasi Kuvendi u shpreh në datë 11.11.2019, duke emëruar dy gjyqtarë kushtetues, Presidenti konstatoi rënien e kushtit pezullues dhe vijoi shqyrtimin e praktikës për t'u shprehur për emërimin e Gjyqtarit Kushtetues, i shpallur për aplikim në datën 4.03.2019.

Pasi Kuvendi zgjodhi zonjën Elsa Toska dhe zonjën Fiona Papajorgji si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, në kundërshtim me radhën që dikton Kushtetuta, në vakancën e Presidentit mbetën në garë për konkurrim për plotësimin e vakancës së shpallur vetëm 2 (dy) kandidatë: **Arta Vorpsi** dhe **Marsida Xhaferllari**.

Ndërmjet këtyre dy kandidatëve, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11350, datë 13.11.2019, emëroi si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese zonjën Marsida Xhaferllari. Ky dekret është shoqëruar

me arsyetimin²⁶ e përzgjedhjes së kësaj kandidature dhe procedurës së ndjekur për plotësimin e kësaj vakance, akte këto që u publikuan në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës²⁷ dhe përmes mjeteve të informimit publik.

Përzgjedhja e kësaj kandidature midis dy kandidateve të mbetura në garë, u bë në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit 125, pika 1, dhe parashikimit të nenit 149/d, pika 1, e Kushtetutës²⁸. Fjalja e fundit e kësaj pike parashikon se “**Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati**”. Kjo do të thotë që lista **nuk është domosdoshmërisht e ngurtë**. Ajo mund të plotësohet me kandidatët që pasojnë në rastet kur 1 apo më shumë kandidatë, nga 3 nivelet e sipërme, nuk janë **më kandidatë** për arsye të ndryshme.

Nëse do të ishte ndryshe, Kushtetuta nuk do ta kishte këtë parashikim, madje do të mund të **pohonte se lista është e mbyllur dhe se emërimi/zgjedhja duhet të bëhet vetëm nga 3 kandidatët që përmbante në fazën fillestare lista; ose do të mund të parashikonte se autoriteti vendimmarrës (organit të emërtesës) i përcillen vetëm emrat e 3 kandidatëve të parë, kurse kandidatët e tjerë, nuk i përcillen autoritetit vendimmarrës.**

Neni 125, pika 1, e Kushtetutës parasheh se lista e përcjellë nga KED mund të përmbajë emrat e më shumë se 3 kandidatëve, por se emërimi/zgjedhja mund të bëhet vetëm ndërmjet 3 kandidatëve të renditur më lart. Lista “ngurtësohet” vetëm në një rast, por ky rast ka të bëjë me variantin kur autoriteti vendimmarrës hesht brenda afatit 30-ditor. Edhe në këtë rast, “ngurtësimi” i listës i referohet vetëm kandidatit të renditur i pari prej KED. Pra, në këtë rast, autoriteti vendimmarrës nuk ka të drejtë të rirendisë hierarkisht 3 kandidatët e parë, sepse në këtë mënyrë do të kompromentohej mekanizmi zhblllokues që parashikon Kushtetuta (i pari i renditur, konsiderohet i emëruar në rast heshtjeje).

Në këtë mënyrë, referuar dispozitave të mësipërme, rezulton se Presidenti i Republikës, u gjend përpara një situatë të shkaktuar nga KED dhe e pasuar me vendimmarrjen e Kuvendit në datën 11.11.2019, ku në garë mbetën vetëm 2 (dy) kandidatë, për të emëruar njërin prej tyre si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

Duke vlerësuar objektivisht të gjithë situatën e krijuar, si pasojë e veprimeve të organeve të tjera (KED- Kuvend), të cilat prishën radhën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, Presidenti i

²⁶Shiko Dekretin nr. 11350, datë 13.11.2019 të Presidentit të Republikës dhe arsyetimin e tij.

²⁷Për më shumë, shiko link-un: <https://president.al/presidenti-meta-dekreton-emerimin-e-znj-marsida-xhaferllari-gjyqtare-te-gjykates-kushtetuese-2/>

²⁸Neni 149/d pika 1 e Kushtetutës parashikon: “1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. **Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati**”.

Republikës, përfundimisht vendosi të procedojë me këtë numër kandidatësh, për zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues, për plotësimin e vakancës së shpallur prej tij, pasi ekzistonte mundësia për përzgjedhjen e një kandidati të përshtatshëm për t'u emëruar anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Edhe pse Kushtetuta dhe ligji, kërkojnë numrin 3 të kandidaturave, Presidenti i Republikës vlerësoi, se në rastin konkret, pasja e 2 (dy) alternativave garantonte thelbin e të drejtës së zgjedhjes dhe se fryma e Kushtetutës ruhej. Për Presidentin e Republikës, garantohej kështu hapsira diskrecionare e vlerësimit midis më shumë se 1 kandidati; ndryshe do të ishte një emërim automatik, pra që të drejtën e emërimit ta merrte një organ tjetër që nuk e ka në kompetencë kushtetuese.

Për këto shkaqe, vlerësoi të operojë me përzgjedhjen e zonjës Marsida Xhaferllari për të qënë anëtare e Gjykatës Kushtetuese, e cila përpos të tjerave, kishte treguar integritet, pasi ishte i vetmi nga 6 kandidatët e mbetur në garë, që kishte aplikuar vetëm për një vend vakant nga 6 (gjashtë) vende të shpallura për aplikim nga organet e emërtesës (President, Kuvend) dhe që u shqyrtuan nga KED. Me shkresën nr. 4237 prot, datë 13.11.2019, Institucioni i Presidentit të Republikës, njoftoi Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe KED, mbi emërimin e zonjës Marsida Xhaferllari si anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

XV. Betimi i gjyqtarëve të rinj Kushtetues të zgjedhur nga Presidenti dhe Kuvendi, si kusht përpara fillimit të ushtrimit të mandatit.

Kushtetuta në nenin 129, parashikon se **Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.**

Presidenti i Republikës, në datë 14 nëntor 2019, administroi njoftimin zyrtar dhe aktet e emërimit nga Kuvendi të zonjës Elsa Toska dhe Fiona Papajorgji si anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Menjëherë pas këtij njoftimi, Presidenti i Republikës me shkresën **nr. 4312/1 prot, datë 14.11.2019**, njoftoi institucionet respektive dhe bëri publik përmes mjeteve të informimit publik, organizimin e ceremonisë së betimit të gjyqtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, Elsa Toska, Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji²⁹, për t'u betuar respektivisht në datën 14.11.2019, në këto orare:

1. Znj. Elsa Toska, në orën 19:00;
2. Znj. Marsida Xhaferllari, në orën 19:30;
3. Znj. Fiona Papajorgji, në orën 20:00.

²⁹ Për më shumë, shiko link-un: <https://president.al/njoftim-mbi-organizimin-e-ceremonise-se-betimit-te-gjyqtareve-te-rinj-te-gjykates-kushtetuese/>

Në ceremoninë e betimit sipas rradhës, morën pjesë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese znj. Vitore Tusha dhe z. Besnik Muçi dhe anëtarët e rinj të betuar të Gjykatës Kushtetuese³⁰.

Njoftimi mbi realizimin e procesit të betimit, iu përcoll menjëherë dhe zyrtarisht, me shkresën nr. 4313/1 prot, datë 14.11.2019, Kuvendit të Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, pas plotësimit edhe të kushtit të fundit që parashikon neni 129 i Kushtetutës për fillimin e detyrës, betimin përpara Presidentit të Republikës, anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese nisën detyrën.

Aktualisht 4 anëtarët të Gjykatës Kushtetuese, znj. Vitore Tusha, Znj. Elsa Toska, znj. Marsida Xhaferllari dhe znj. Fiona Papajorgji, kanë filluar menjëherë ushtrimin e mandatit të tyre duke shqyrtuar çështjet në kolegjet paraprake (viti 2019- 2020) e duke marrë vendime për kalimin ose moskalimin në seancë gjyqësore të kërkesave të administruara përpara kësaj gjykate³¹.

XVI. Sjellja e kandidatës Arta Vorpsi pas plotësimit të vakancës së Presidentit të Republikës.

Pasi Presidenti i Republikës emëroi me Dekretin nr. 11350, datë 13.11.2019, zonjën Marsida Xhaferllari si anëtare të Gjykatës Kushtetuese dhe bëri publik vendimin e tij, kandidatja tjetër, zonja Arta Vorpsi, e cila nuk u përzgjedh nga Presidenti dhe u përjashtua nga votimi i Kuvendit duke e konsideruar të vetëzgjedhur, hartoi dhe nënshkroi një deklaratë (me nënshkrim të legalizuar përpara një Noteri), më datë 13.11.2019.

Këtë deklaratë personale, zonja Vorpsi e përcolli pranë Presidentit të Republikës, administruar me nr. 4314 prot., datë 14.11.2019. Kjo deklaratë është një akt i njëanshëm dhe i pakërkuar, ardhur nga një subjekt/individ që nuk vlerësohej se përmbushte ndonjë nga kushtet apo kriteret që të detyronte realizimin e një veprimi të tillë.

Zonja Arta Vorpsi, është vlerësuar si kandidate nga Presidenti i Republikës, në vakancën e tij, por që nuk është përzgjedhur as prej tij dhe as prej Kuvendit të Shqipërisë, dhe as shpallur me ndonjë vendimmarrje që ta ketë zgjedhur/emëruar si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese.

Ky veprim i pamatur, joprofesional dhe antikushtetues i zonjës Arta Vorpsi, i koordinuar me mazhorancën³² dhe në të njëjtën linjë me veprimtarinë e paligjshme të KED, konfirmoi dhe një herë

³⁰Për më shumë, shiko linqet:- <https://president.al/betohet-para-presidentit-te-republikes-anetarja-e-re-e-gjykates-kushtetuese-znj-elsa-toska/>

- <https://president.al/betohet-para-presidentit-te-republikes-anetarja-e-re-e-gjykates-kushtetuese-znj-marsida-xhaferllari/>

- <https://president.al/betohet-para-presidentit-te-republikes-anetarja-e-re-e-gjykates-kushtetuese-znj-fiona-papajorgji/>

³¹ Për më shumë, shiko linqet:

http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_moskalimi_te_ceshtjeve_ne_seance_gjyqesore_101_1.php

http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_moskalimi_te_ceshtjeve_ne_seance_gjyqesore_101_1.php

³² Për më shumë, shiko minutat 2-3, në transmetimin e Report TV, datë 11 qershor 2019, në link-un:

<https://shqiptarja.com/video/kur-ngrihet-gjykata-kushtetuese-dhe-a-e-pengon-dot-presidenti-ulsi-manja-tregon-fazen-ku-ndodhet>

se kjo kandidate nuk gëzonte aftësitë profesionale, integritetin dhe paanshmërinë profesionale për t'u zgjedhur si anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e thotë qartë në nenin 129, se betimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese bëhet përpara Presidentit të Republikës!

XVII. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë pas betimit të gjyqtarëve Kushtetues.

Sapo gjyqtarët Kushtetues filluan detyrën, Kuvendi nisi një proces anatemimi të veprimeve dhe vendimmarrjes së Presidentit të Republikës, me qëllim që gjyqtarës së zgjedhur nga Presidenti i Republikës t'i bëhej i pamundur ushtrimi i detyrës.

Në datën 15 nëntor 2019 (një ditë pas betimit të gjyqtarëve), Kuvendi miratoi një rezolutë ku ndër të tjera, citon se: *“Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje, në radhë të parë Gjykatës Kushtetuese, të marrë përsipër përgjegjësinë e autoritetit që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, për të mos lejuar delegitimimin institucional që me fillimin e veprimitarisë së tij, por të zbatojë urdhërimin kushtetues të renditjes së përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që përcakton znj. Arta Vorpsi si gjyqtare të emëruar të Gjykatës Kushtetuese.*

Çdo tentativë apo veprim tjetër që synon zbatimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 350, datë 13.11.2019, për emërimin e znj. Marsida Xhaferllari si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese dhe që konsiderohet në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën dhe me ligjin, ngarkon me përgjegjësi cilindo që do të guxojë të ndër marrë këtë veprim me pasoja të rënda për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të tjera të zbatojnë me përgjegjësi detyrat, pa krijuar asnjë pengesë, për fillimin e ushtrimit të detyrës së gjyqtareve kushtetuese znj. Arta Vorpsi, znj. Elsa Toska dhe znj. Fiona Papajorgji, të emëruara në mënyrë legjitime sipas procedurës kushtetuese, të zhvilluar për këtë qëllim nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe Kuvendi i Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të shmangies së çdo tentative për bllokimin e Reformës në Drejtësi, angazhohet të rishikojë legjislacionin për të shmangur krijimin, në të ardhmen, të situatave që pengojnë në mënyrë abuzive funksionimin e organeve kushtetuese të vendit”.

Nga përmbajtja e kësaj rezolute dallohet qëndrimi tërësisht politik i mazhorancës socialiste, për të kapur Gjykatën Kushtetuese, dhe për t'i rrëmbyer Presidentit të Republikës emërimin e një anëtari në të drejtën e tij kushtetuese për të zgjedhur. Kjo rezolutë faktton edhe se mazhoranca do të vijonte veprimet me të gjitha format që të bënte të mundur, imponimin me çdo kusht dhe çdo mjet të zonjës Arta Vorpsi, si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

XVIII. Përmbushja e një detyrimi ligjor nga Presidenti i Republikës, për Kallëzimin e veprave penale të konsumuara personalisht nga zoti Ardian Dvorani në detyrën e Kryetarit të KED, në tejkalim dhe mospërmbushje të ushtrimit të rregullt të detyrës si Kryetar i KED.

Bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, Presidenti i Republikës me aktin nr. 4350 prot., datë 19.11.2019³³, paraqiti kallëzim penal përpara organit të akuzës me qëllim fillimin e hetimeve ndaj zotit Ardian Dvorani për veprat penale të “*Shpërdorimit të detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe “*Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore*”, parashikuar nga neni 246 i Kodit Penal. **Kjo pasi nga tërësia e rrethanave vlerësohet se përgjatë ushtrimit të detyrës së Kryetarit të KED, ai me dashje ka shpërdoruar funksionin publik që i është ngarkuar dhe ka marrë përsipër të realizojë.**

Faktet penale për të cilat zoti Dvorani u kallëzua ishin të përsëritura në më shumë se një herë dhe të kryera me **dashje direkte. Konkretisht:**

- Kryetari KED me veprimet e tij personale administrative përcolli listat përkundrejt organeve të emërtesës (President dhe Kuvend) dy e nga dy dhe të diferencuara në kohë, gjë e cila nuk respektonte as kohën e përpilimit e miratimit të listave, as radhën e miratimit të tyre dhe as rendin kronologjik të detyrueshëm, që ka caktuar Kushtetuta dhe ligji, për plotësimin e çdo vendi vakant.
- Për të mbrojtur gjithë procesin e emërimit/zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe për të respektuar radhën e emërimit të tyre, Kryetari i KED, doemos, në fazën përfundimtare të dërgimit të listave përfundimtare, duhej të mbante parasysh dhe të respektonte kërkesat e Kushtetutës dhe ligjit.
- **KED në mënyrë kolegjiale nuk ka marrë asnjë vendim për mënyrën dhe kohën e dërgimit të listave pranë organeve të emërtesës. Ky veprim administrativ është kryer vetëm në mënyrë individuale nga Kryetari i KED, i cili sipas nenit 226 pika 2/e, e ligjit nr.115/2016, ka si funksion vetëm të nënshkruajë aktet e verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes dhe t’ia përcjellë ato organit të emërtesës, pa ndërhyrë në vendimin e marrë prej Këshillit.**
- Kryetari i KED, zoti Ardian Dvorani vetëm me hartimin dhe nënshkrimin e një shkrese administrative në emrin e vet, që përcillte dy lista të kandidatëve për dy vakanca njëherazi, ka shkelur rëndë ligjin, dhe ka provokuar t’i imponojë Presidentit të Republikës “*një rregull të ri*” me qëllim që ai të shkelte hapur Kushtetutën dhe radhën e emërimit të anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese.
- Dërgimi për botim në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 132, i datës 21 shtator 2019, një vendim që sipas ligjit nuk botohet në Fletoren Zyrtare, dhe që

³³ Për më shumë, shiko Kallëzimin Penal depozituar me shkresën me nr. 4350 prot, datë 19.11.2019, të Presidentit të Republikës në Prokurorinë SPAK, ose konsultojë në link-un: <https://president.al/presidenti-meta-kallezon-penalisht-kryetar-in-e-keshillit-te-emerimeve-ne-drejtësi-z-ardian-dvorani/>

ishte tashmë i botuar siç parashikonte ligji në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, është një tjetër veprim i dënueshëm i Kryetarit të KED-së.

- Moszbardhja dhe mospublikimi për një vit rresht i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në kundërshtim me nenet 226, 232 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikës 17 të Rregullores së KED, është një tjetër fakt penal i konsumuar nga Kryetari i KED, për të cilin është kallzuar nga Presidenti i Republikës.

Presidenti është paraqitur personalisht në Prokurori dhe ka dhënë shpjegimet e të dhëna shtesë më të hollësishme mbi kallzimin e paraqitur. Më pas, organi i prokurorisë ka thirrur për të dhënë shpjegime të kallzuarin Ardian Dvorani, Avokatin e Popullit, dhe një pjesë të anëtarëve të KED. Ky kallëzim penal është duke u hetuar aktualisht nga Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion (SPAK).

XIX. Veprimtaria e Kuvendit në mbrojtje të Kryetarit të KED Ardian Dvorani.

Sapo Presidenti i Republikës, paraqiti kallëzim penal dhe bëri publik të dhënat e konstatuara përgjatë veprimtarisë antiligjore të Kryetarit të KED, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, u investua menjëherë për t'i siguruar Ardian Dvoranit mbrojtje politike për veprimet e tij.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, në datë 21 nëntor 2019 (dy ditë pas depozitimit dhe bërjes publik të kallëzimit penal nga Presidenti), paraqiti në Kuvend një kërkesë për të shtuar objektin e Komisionit Hetimor Parlamentar *“Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”*.

Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në këtë kërkesë dhe kërkesën e Komisionit Hetimor për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së tij, me Vendimin nr. 140, datë 5.12.2019, ka vendosur ndryshimin e objektit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor, zgjatjen e afatit me 4 muaj të këtij Komisioni dhe përfshirjen në objekt edhe: *“Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues”*.

Në lidhje me veprimtarinë dhe objektin fillestar të Komisionit Hetimor, Komisioni i Venecias ka dhënë tashmë Opinion **Nr. 959 / 2019, në datën 14 tetor 2019**³⁴. Ndonëse ishte e pritshme që

³⁴ Shiko bashkëlidhur Opinion Final të Komisionit të Venecias nr. 959/2019, datë 14 tetor 2019.

Kuvendi të konkludonte mbi objektin e hetimit parlamentar sipas këshillave të Opinionit të Komisionit të Venecias, Kuvendi veproi në të kundërt.

Në datën 5 dhjetor 2019, Kuvendi vendosi të shtojë objektin e hetimit parlamentar për veprime të tjera të Presidentit (emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese), që nuk lidheshin me objektin fillestar, në tejkalim kushtetues të kompetencës kontrolluese/hetimore të Kuvendit, që rrjedh nga zgjerimi i objektit hetimor dhe zvarritja e veprimtarisë së komisionit hetimor parlamentar.

Ashtu siç nënvizohet në paragrafin 93, të Opionionit Final Nr. 959/2019 të Komisionit të Venecias mbi kompetencën e Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve, Kuvendi duke zgjeruar objektin e hetimit parlamentar ndaj Presidentit, rriti jo vetëm ka rritur tensionet, por ka cenuar parimin e kontrollit dhe balancës midis dy institucioneve, ndërkohë që, ata ndajnë kompetenca të veçuara në emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sot Shqipëria, ashtu siç citon edhe Komisioni Venecias në përfundimet e Raportit nr. 959/2019 (paragrafi 93), ndodhet në një situatë ku Kuvendi zotërohet vetëm nga një forcë politike që drejton njëkohësisht dhe të gjitha bashkitë dhe këshillat bashkiakë të vendit.

XX. Nisma legislative e Kuvendit për të ndryshuar ligjin e Gjykatës Kushtetuese.

Me qëllim legjitimimin e deklaratës noteriale të kandidatës Arta Vorpsi dhe për ta njehsuar atë si akt betimi për fillimin e detyrës si gjyqtar Kushtetues, mazhoranca Socialiste ndërmori zyrtarisht një nismë të re ligjore³⁵. Kjo nismë ligjore është depozituar në Kuvend nga tre deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, njëkohësisht anëtarë të Komisionit Hetimor, parashikon të dhunojë dispozitën kushtetuese të betimit përpara Presidentit të Republikës, duke i dhënë vlerë ligjore prapavepruese betimit privat jashtë zyrës së Presidentit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar”, është depozituar në Kuvend në datë 6 dhjetor 2019, dhe është qartazi tregues i pakundërshtueshëm se mazhoranca socialiste është e vendosur për të kapur me çdo kusht të gjitha emërimet në Gjykatën Kushtetuese. Duke mos u mjaftuar me emërimin e kandidatëve të targetuar nga parlamenti monopartiak, mazhoranca socialiste tenton të rrëmbejë edhe emërtesën e Presidentit në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim prishjen e balancës dhe kapjen e Gjykatës Kushtetuese.

³⁵ Për më shumë, shiko link-un: <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/51305>

XXI. Kriza e përfaqësimit *sui generis* ku ndodhet sot Kuvendi i Shqipërisë.

Polarizimi i fortë politik ka mbizotëruar gjatë 2018-2019. Mungesa e dialogut politik ndërmjet mazhorancës dhe opozitës thelluan ndasitë dhe mosbesimin ndërmjet palëve. Qëndrimet e kundërta u thelluan më tej kur opozita paralajmëroi dorëzimin e mandateve parlamentare pasi mazhoranca rrëzoi me votë në Kuvend nismën e saj për ndryshime kushtetuese për realizimin e procesit *vetting* në klasën politike.

Më herët opozita pat ngritur shqetësimin për kufizimin dhe bllokimin e rolit të saj mbikëqyrës në parlament, përfshirë të drejtën e ngritjes së komisioneve hetimore dhe thirrjes për raportim përpara Kuvendit të anëtarëve të kabinetit qeveritar. Opozita pat denoncuar gjithashtu keqpërdorimin e veprimtarisë ligjbërëse të mazhorancës socialiste në Kuvend, e cila miratoi përmes ligjeve të posaçme antikushtetuese kontrata korruptive konçesionare.

Çështjet e depozituara pranë Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e akteve dhe veprimeve të qeverisë nuk mund të gjykoheshin për shkak të daljes jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese.

Nxjerrja jashtë funksioni e Gjykatës Kushtetuese prej më shumë se dy vitesh ishte një nga faktorët kryesorë që ndikuan në përshkallëzimin drejt kësaj krize të paprecedentë kushtetuese, institucionale dhe të përfaqësimit.

Nën presionin e shtuar të mbështetësve të tyre dhe të zërave publikë me peshë në opinionin vendas, partitë opozitare deklaruan dorëzimin në bllok të dorëheqjes nga mandatet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë. Opozita dorëzoi në bllok mandatet parlamentare (**182** mandate të dorëzuara/refuzuara), ndërsa mazhoranca përshpejtoi procedurat e dorëheqjeve dhe zëvendësimin e tyre, në shkelje të Kushtetutës, Kodit Zgjedhor dhe Rregullores së Kuvendit.

Në total, kanë refuzuar ushtrimin/marrjen e mandatit **182 deputetë dhe kandidatë për deputet**. Kanë refuzuar marrjen e mandatit **124 kandidatë** për deputet nga listat shumëemërore të opozitës. Kanë dhënë dorëheqje në bllok nga mandatet **58 deputetë**.

Numri **aktual** i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë është **122**, ndërkohë që **Kushtetuta përcakton se numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë duhet të jetë 140. 18 mandate** të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kanë mbetur **të paplotësuara** për shkak të shterimit të listave shumëemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike dhe të gjithë partive të tjera opozitare.

Opozita nuk u regjistrua në zgjedhjet për pushtetin vendor. Procesi i votimeve për pushtetin vendor, u zhvillua më 30 qershor 2019, pa pjesëmarrjen e opozitës, pa konkurrim, pa një datë për mbajtjen e zgjedhjeve të përcaktuar sipas ligjit nga Presidenti i Republikës. Kjo solli si rezultat që

aktualisht, 61/61 bashkitë dhe këshillat bashkiakë të vendit, të drejtohen dhe përfaqësojnë vetëm Partinë Socialiste.

Ky proces antikushtetues dhe mono- partiak votimesh i zhvilluar nga mazhoranca dhe përfaqësuesit e saj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është një nga çështjet që pritet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, çka e bën më akut interesin dhe aksionin politik të mazhorancës për kapjen e Gjykatës Kushtetuese.

Aktualisht, Partia Socialiste ka uzurpuar pothuajse të gjithë pushtetet, ekzekutivin, legjislativin dhe pushtetin vendor. Së fundmi, ajo kaloi një tjetër paketë ligjore në kuvendin mono- partiak që kufizon lirinë e shprehjes dhe vendos nën kontroll median elektronike, duke i dhënë kompetenca gjyqësore një organi administrativ të varur nga ekzekutivi. Kjo paketë ligjore shkaktoi reagime të ashpra brenda dhe jashtë vendit.

B. PYETJET PËR TË CILAT PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KËRKON OPINION NGA KOMISIONI I VENECIAS

Shqipëria ndodhet prej një viti në një krizë politike, kushtetuese, institucionale dhe përfaqësimi të paprecedentë, *sui generis*.

Në kushtet kur vendi ndodhet:

- Pa Gjykatë Kushtetuese funksionale prej dy vjetësh;
- Pa Gjykatë të Lartë funksionale;
- Sistemi gjyqësor perceptohet gjerësisht si i paralizuar, apo si i kapur nga mazhoranca qeverisëse;
- Me Parlamentin mono- partiak prej 122 deputetësh, dhe që nuk plotëson dot kuorumin kushtetues prej 140 deputetësh, për shkak të dorëheqjes në bllok të 182 deputetëve dhe kandidat-deputetëve të opozitës nga mandatet parlamentare;
- Qeveria, Parlamenti, Bashkitë dhe të gjithë Këshillat Bashkiakë janë në duart e një partie të vetme, ashtu si dhe pothuajse të gjitha organet e pavarura emëruar nga kjo shumicë qeverisëse;

Duke patur parasysh që opinionet e Komisionit të Venecias janë burim reference për të gjitha vendet anëtare, dhe përballë nevojës për të reflektuar ndaj gjendjes aktuale në Shqipëri, do të donim **të paraqisnim disa pyetje** për të qartësuar modelin e një demokracie funksionale dhe shtetit të së drejtës, bazuar në parimet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

I. MBI ZGJERIMIN E OBJEKTIT TË KOMISIONIT HETIMOR NGA KUVENDI MONO-PARTIAK

Në Opinionin **No. 959 / 2019 CDL-AD (2019) 019**, Komisioni i Venecias vërente se: **“78. Në kohën e përgatitjes së këtij opinionit, Komisioni i posaçëm hetimor ishte ngritur, por nuk kishte hartuar ende raportin e tij, duke shprehur dëshirën për të marrë në konsideratë Opinionin e Komisionit të Venecias.”**

1. A i mori në konsideratë Opinionin dhe këshillat e Komisionit të Venecias, Komisioni Hetimor Parlamentar shqiptar?

2. Lidhur me zgjerimin e objektit hetimor dhe zvarritjen e veprimtarisë së Komisionit Hetimor Parlamentar për shkelje të pretenduar të ligjit (dhe jo Kushtetutës), vlerësoni se:

- ***A i shërben uljes apo rritjes së tensioneve?***

- *A i shërben apo e asgjëson më tej mekanizmin e kontrollit dhe balancës midis pushteteve, në një situatë kur Parlamenti dhe të gjitha Bashkitë dominohen nga një parti e vetme?*³⁶

3. A përbën tejkalim kushtetues të kompetencës hetimore të Kuvendit, zgjerimi i objektit të hetimit dhe zvarritja e veprimtarisë së Komisionit Hetimor Parlamentar³⁷?

4. Në Opinionin No. 959 / 2019 CDL-AD(2019)019, Komisioni i Venecias vëren se: **“80. Ndërsa përbërja e gjykatës kushtetuese ngjall gjithmonë interes për aktorët politikë, referimi i një rasti të tillë (shkarkimi i Presidentit) në kohën kur përzgjidhen gjyqtarët (e Gjykatës Kushtetuese) nuk është sfondi ideal për garantimin e pavarësisë së tyre.”**

4.1 Në rastet kur qeveria dhe parlamenti janë një, dhe kur Presidenti është i vetmi aktor institucional jashtë tutorialit të qeverisë: A përbën zgjerimi i objektit hetimor për shkelje të pretenduar të ligjit (dhe jo të Kushtetutës) rritje të rrezikut eminent për të emëruar politikisht anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë vetëm nga një parti, pra vetëm nga një aktor politik?

4.2 A përbën kjo sjellje e Kuvendit tejkalim të kompetencave kushtetuese parlamentare që lidhen me emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese?

4.3 A e vendos zgjerimi i paligjshëm i objektit të Komisionit Hetimor Parlamentar Presidentin nën presion politik, që të emërojë në Gjykatën Kushtetuese kandidatët e preferuar nga partia në pushtet?

4.4 A rrezikon të cenojë legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese?

4.5 Përdorimi i komisionit hetimor, apo veprimeve të tjera të Kuvendit monopartiak³⁸, a rrezikon të krijojë precedent për ushtrimin e trysnisë së papërshtatshme politike nga mazhoranca qeverisëse edhe ndaj Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese prej saj?

II. GJYKATA KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese qëndron në krye të piramidës së institucioneve të drejtësisë në Shqipëri.

Në opinionin e ndërmjetëm, No. 824 / 2015 CDL-AD (2015)045, paragrafët 23 dhe 24, dhe Opinionin final No. 824/2015 CDL-AD(2016)009, paragrafët 36, 37, 39, mbi amendamentet kushtetuese për gjyqësorin, Komisioni i Venecias paralajmëroi mbi rreziqet në kushtet kur:

³⁶ Siç vlerësohet në paragrafin 93, të Opinionit të Komisionit të Venecias.

³⁷ Referuar parimeve kushtetuese dhe jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese të RSh në vendimet nr. 20/2007, nr.18/2003, nr.30/2014, nr.38/2015.

³⁸ Rezoluta e Kuvendit datë 15.11.2019, nëpërmjet së cilës i bëhej thirrje çdo institucioni tjetër publik për mosnjohjen e emërimit të Presidentit të Republikës në Gjykatës Kushtetuese.

1. Gjykata Kushtetuese krijohet nga e para;
2. Mazhoranca ka shumicë të cilësuar;
3. Presidenti dhe Parlamenti i përkasin të njëjtës forcë politike.

Komisioni i Venecias kërkoi rregulla të qarta për tranzicionin gradual të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përfshirë përcaktimin eksplicit të institucioneve të emërtesës dhe *modus operandi* (radhës që përcakton Kushtetuta), në mënyrë që kjo gjykatë të mos kapet politikisht nga partia në pushtet.

1. Në rastet kur parlamenti zotërohet *de facto* tërësisht nga një forcë politike, pra zotëron edhe shumicën e cilësuar prej 2/3 të votave të Kuvendit, emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese vetëm nga një parti: A përbën rrezik të emërimit politik të kësaj gjykate?³⁹
2. A është zgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese vetëm nga një aktor politik në përputhje me përvojën kushtetuese europiane dhe rekomandimet e shprehura nga Komisioni i Venecias në opinionin për Shqipërinë dhe Malin e Zi?
3. Krijimi i Gjykatës Kushtetuese vetëm nga një forcë politike, pra vetëm nga një aktor politik, a përbën cenim të nenit 6 të KEDNJ-së, si një gjykatë e formuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin?
4. Mosrespektimi i *modus operandi* (radhës që përcakton Kushtetuta) në emërimin e gjyqtarëve që në momentin e parë të zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe kur Gjykata Kushtetuese krijohet nga e para, a është në përputhje me përvojën kushtetuese europiane dhe a rrezikon të krijojë precedent të rrezikshëm për të ardhmen?
5. A legjitimohet Kuvendi të ndërhyjë në procedurën e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që i përkasin organeve të tjera të emërtesës, pra Presidentit apo Gjykatës së Lartë?
6. A mundet Kuvendi të ndërhyjë në marrëdhënien që krijohet midis Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe organeve të tjera të emërtesës - Presidentit apo Gjykatës së Lartë, në kushtet kur kompetenca kushtetuese e Kuvendit është e kufizuar në procesin e zgjedhjes së vetëm 3 prej 9 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese?

III. MBI VEPRIMTARINË E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

1. Në rastin kur Gjykata Kushtetuese krijohet nga e para, kur shumica parlamentare dhe Presidenti nuk i përkasin të njëjtës forcë politike, dhe kur parlamenti mono- partiak kërkon t'i rrëmbejë Presidentit kompetencën kushtetuese për të emëruar anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, a

³⁹ Referuar Opinioneve CDL(2016) 002, të Komisionit të Venecias.

përbën rrezik që mazhoranca politike të emërojë më shumë se 1/3 e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese?

2. Mosrespektimi i *modus operandi* (radhës që përcakton Kushtetuta): a është shkelje e gërmës së Kushtetutës, frymës së saj, si dhe standardit të përbërjes së balancuar të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese?

3. Midis detyrimit kushtetues⁴⁰ për respektimin e *modus operandi* (radhës që përcakton Kushtetuta), dhe parashikimit ligjor⁴¹ për respektimin e afatit 30 ditor, cili detyrim mbizotëron sipas parimit të hierarkisë së normave sipas Kushtetutës në Republikën e Shqipërisë?

4. A përbën mosrespektimi i *modus operandi* (radhës që përcakton Kushtetuta) ndërhyrje në hapësirën e përzgjedhjes së organit tjetër të emërtesës?

5. Sipas praktikës kushtetuese europiane, a është e pranueshme që përmes keqinterpretimit të mekanizmit zhblllokues, Presidentit t'i rrëmbehet kompetenca kushtetuese për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, edhe pse ai ka shprehur vullnetin në vazhdimësi e në mënyrë të dokumentuar se do ta ushtrojë këtë kompetencë?

6. A mundet të vendosë precedent të rrezikshëm deformimi i mekanizmit zhblllokues, duke e shndërruar atë praktikisht në një mekanizëm rrëmbimi të kompetencës kushtetuese?

7. Mosplotësimi i numrit minimal të 3 kandidatëve të ndryshëm për çdo vakancë nga KED, a sjell “një zgjedhje të detyruar” ose “të paracaktuar”?

8. A përbën kjo situatë rrezik të lartë për asgjësimin e kompetencës substanciale të zgjedhjes/emërimit?

IV. MBI VEPRIMTARINË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Pas shqyrtimit me vëmendjen e duhur të Opinionit tuaj të paraqitur me nr. CDL-AD (2016) 009, në faqen 9 të tij, citojmë: “*Në përvojën Kushtetuese Evropiane, zgjedhja nga parlamenti e gjyqtarëve kushtetues shpesh mbështetet nga kërkesa për shumicë të cilësuar me qëllim që të sigurohet një zgjedhje e përbashkët me mbështetjen pluraliste të partive politike dhe jo vetëm nga shumica.*” Duke mbajtur në konsideratë këtë vlerësim:

1. A bie ndesh zgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga një parlament mono-partiak me frymën e ndryshimeve Kushtetuese, rekomandimin (e mësipërm) e Komisionit të Venecias, dhe garantimin në kontekstin afatgjatë të paanësisë së anëtarëve të kësaj gjykate?

⁴⁰ Neni 179, pika 2 dhe 12, e Kushtetutës.

⁴¹ Neni 7/b, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000.

2. Kur Qeveria, Kuvendi, të gjitha Bashkitë, Këshillat Bashkiakë dhe thuajse të gjitha institucionet e pavarura, janë në duart e një partie të vetme: a i shërben kapja ose paralizimi i Gjykatës Kushtetuese interesit politik të kësaj force për të mos patur një mekanizëm kontrolli të pavarur, siç duhet të jetë Gjykata Kushtetuese?
3. Po kur ky parlament mono- partiak tenton të marrë edhe më shumë se 1/3 e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese duke rrëmbyer emërtesën e Presidentit, a kemi të bëjmë me tejkalim të kompetencave dhe dominim të përbërjes së Gjykatës nga kandidatë që gëzojnë mbështetjen vetëm të një force politike?
4. Refuzimi i Kuvendit për të bashkëpunuar me Presidentin e Republikës⁴², votimi në seancën plenare të datës 11 nëntor 2019 dhe miratimi i Rezolutës datë 15 dhjetor 2019, a dëshmojnë shkelje të parimit të luajalitetit kushtetues me qëllim kapjen e Gjykatës Kushtetuese?
5. Nisma ligjore e Kuvendit, datë 6 dhjetor 2019⁴³, për miratimin e një ligji që ndryshon procedurën e betimit tek Presidenti i Republikës, dhe dhënia e efektit prapaveprues me synim heqjen e mandatit të anëtarit të emëruar nga Presidenti në Gjykatën Kushtetuese, a dëshmon se Kuvendi mono- partiak synon kapjen me çdo kusht të Gjykatës Kushtetuese?
6. Veprimtaria e Kuvendit për ta vendosur veten në një pozicion supremacie ndaj Presidentit (Komisioni Hetimor) dhe ndaj Gjykatës Kushtetuese (Rezoluta dt.15.11.2019) si dhe nisma ligjore datë 6.12.2019, a përbëjnë goditje të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një shtet të së drejtës?

V. MBI EMËRIMET NË GJYKATËN KUSHTETUESE TË REALIZUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

1. Në kuptim të përvojës kushtetuese europiane, votimi i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nga një listë me vetëm 1 kandidat⁴⁴, a e legjitimon parimin e “zgjedhjes”?
2. Cila është arsyeja që hartuesit e Kushtetutës dhe Komisioni i Venecias 2015- 2016 parashikuan domosdoshmërinë e të paktën 3 kandidatëve për çdo vakancë? Çfarë rreziku mendohej të shmangej dhe a është sot ky rrezik eminent? Çfarë rekomandoni në raste të tilla?

⁴² Presidenti i Republikës, në datë 15.10.2019, 5.11.2019, 7.11.2019 dhe 11.11.2019 ka kërkuar në mënyrë të dokumentuar bashkëpunimin e Kuvendit për të zgjedhur sipas radhës anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

⁴³ Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës kushtetuese”, i ndryshuar”.

⁴⁴ Për më shumë, shiko link-un:

<http://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20191115120928Proc.%20dt.11.11.2019.pdf> faqe 34-35.

3. A ka ndodhur në këtë rast, që kompetencën e zgjedhjes e ka marrë *de facto* një organ që nuk e ka këtë kompetencë, siç është KED⁴⁵?
4. A përbën shkelje kushtetuese përjashtimi nga lista dhe mospërfshirja e znj. Arta Vorpsi nga Kuvendi në votimin e vakancës së 2 dhe të 4 (vakancat e Kuvendit), në seanën plenare të datës 11 nëntor 2019?
5. Sa e pajtueshme është me konceptin e “gjykatës së caktuar me ligj” të përcaktuar nga neni 6 i KEDNJ, zgjedhja nga Kuvendi e dy gjyqtareve në kundërshtim me procedurën kushtetuese?
6. Të gjitha shkeljet kushtetuese të Kuvendit, veçmas dhe/ose së bashku, që janë kryer për emërimin e kandidatëve të tij, a vënë në dyshim garancitë e individëve për një proces të rregullt ligjor?

VI. MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (KED)

1. Qëndrimi në detyrë përtej mandatit kushtetues i Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Ardian Dvorani (16 vite nga 9 që përcakton Kushtetuta), dhe për rrjedhim zgjedhja e tij si Kryetari i KED, a cenon parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve?
2. Veprimtaria e njëanshme e Kryetarit të KED Ardian Dvorani në shkelje të ligjit dhe të vendimeve të KED:
 - Shkelja kushtetuese e *modus operandi* (radhës që parashikon Kushtetuta, e miratuar dhe me vendimet e KED, datë 21.9.2019), nëpërmjet dërgimit të listave të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese në organet e emërtesës dy e nga dy dhe të diferencuara në kohë;
 - Botimi në Fletoren Zyrtare të listës së kandidatëve në kundërshtim me ligjet nr.115/2016 dhe nr. 78/2014, dhe me vendimin kolegjal të KED;
 - Komunikimi zyrtar jashtë objektit të mandatit dhe pa vendimmarrje të KED;
 - Mospublikimi për 1 vit rresht i procesverbaleve të mbledhjeve të KED, në shkelje të ligjit 115/2016 (nenet 226,232) dhe të vendimit nr. 1, datë 08.02.2019 të KED.

Këto shkelje ilustrohen qartë në dy spotet që Istitucioni i Presidentit të Republikës ka publikuar: <http://president.al/spoti-pare-ne-mbrojtje-te-kushtetutes-dhe-integritetit-te-gjykates-kushtetuese/>; <http://president.al/spoti-dyte-ne-mbrojtje-te-kushtetutes-dhe-integritetit-te-gjykates-kushtetuese/>

**A e cënoi integritetin e procesit të përzgjedhjes së kandidaturave për Gjykatën Kushtetuese?
Cila dispozitë kushtetuese parashikon që një organ emërtese mund të emërojë disa gjyqtarë kushtetues njëkohësisht?**

3. Të gjitha faktet, mbi shkeljet procedurale të konstituimit të KED (bllokimi për 2 vjet i funksionimit të KED; pasja e 7 anëtarëve dhe në fund vetëm e 5 anëtarëve nga 9 që duhet të ketë), a e cenojnë legjitimitetin dhe besueshmërinë e KED, me pasojë cenimin e legjitimitetit edhe të produktit të tij, pra të përpilimit listave të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese?

⁴⁵ Referuar CDL-AD (2016) 009, faqe 11, pjesëmarrja e KED në përzgjedhjen paraprake të kandidatëve që më pas do të emërohen nga Presidenti dhe Parlamenti, ul më tej rrezikun e emërimeve politike (neni 125 i Kushtetutës).

4. Përjashtimi i Avokatit të Popullit nga veprimtaria e KED në shkelje të Kushtetutës (neni 179, pika 11) dhe ligjit nr. 115/2016 (neni 233), a e cenon transparencën e vendimmarrjes së KED dhe a kufizon kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit?
5. Sa i rëndësishëm është pluraliteti i kandidaturave në procesin e përzgjedhjes, veçanërisht kur procedohet për disa vakanca njëherësh, dhe kur Gjykata Kushtetuese ripërtërihet nga e para?
6. Në kushtet kur kandidatët për gjyqtar kushtetues, që vijnë nga radhët jashtë gjyqësorit, verifikohen nga KED me ndihmën e Agjencive në varësi të qeverisë (Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave): a ekziston rreziku i favorizimit politik të kandidatëve të preferuar nga Qeveria?
7. Rënditja në krye të listës të kandidatëve që kanë dështuar në testin e Shkollës së Magjistraturës, në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, (neni 42, pika 2, neni 44, gërma c) si dhe ligjit nr. 96/2016 (neni 165, pika 2,3,4,8): A cenon besueshmërinë dhe integritetin e procesit të renditjes së kandidatëve nga KED? Për pasojë a cenon besueshmërinë, nivelin e profesionalizmit dhe integritetin të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht kur kjo e fundit krijohet nga e para?
8. Në kushtet kur në sistemin e brendshëm gjyqësor shqiptar, aktualisht janë në shqyrtim:
 - i. një çështje penale që po hetohet nga SPAK mbi veprimet e paligjshme të Kryetarit të KED Ardian Dvorani; dhe
 - ii. një padi administrative e Avokatit të Popullit, që ka kundështuar aktet nënligjore të miratuara nga KED;

Cili do të ishte efekti i Opinionit të Komisionit të Venecias, përkundrejt hetimit dhe gjykimit të këtyre çështjeve?

Në përfundim të këtij informacioni të plotë mbi çështjen, si dhe pyetjeve të parashtruara më sipër, lutemi gjeni bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues dhe listën e provave të renditura në mënyrë kronologjike.

Duke ju siguruar për konsideratën më të lartë,

Sinqerisht,

Ilir Meta